



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
KUKËS

RAPORT VJETOR – 2021

**MBI ECURINË E PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË KUKËS PËR VITIN 2021**

SHKURT 2021

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara nga neni 50, pika 2 të ligjit Nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, pasqyron dhe analizon në raportin vjetor për vitin 2021, drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit, të dhënat për numrin, llojin, shtrirjen territoriale, intesitetin dhe format e kriminalitetit, të dhënat e detajuara përsa i përket efektivitetit të ndjekjes penale si dhe cilësisë së përfaqësimit të akuzës në gjyq, informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, të dhënat për ngarkesën në punë për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore të seksionit, të dhënat për administrimin e prokurorisë si dhe të dhëna të tjera, dhe problematikat e ndeshura.

I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!

Nëpërmjet këtij raporti, paraqesim në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar treguesit e punës për periudhën njëvjeçare. Puna e prokurorisë ka synuar në vijimësi në realizimin me korrektësi të detyrave tona Kushtetuese dhe Ligjore.

Në tërësi vihet re një ngarkesë e cila në disa drejtime është përballuar nga një staf i reduktuar i prokurorëve dhe i oficerëve të policisë gjyqësore, në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim si dhe në kryerjen e detyrave të tjera administrativo penale.

Gjatë vitit 2021, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ka në strukturë një organikë prej 5 prokurorësh ku efektivisht gjatë këtij viti kanë ushtruar detyrën vetëm 3 prokurorë dhe 2 Oficer të Policisë Gjyqësore, fakt që ka ndikuar në nivelin e ngarkesës së prokurorëve, numrin e dosjeve të përfunduara, numrin e dosjeve të mbartura në hetim dhe problematika të tjera të dala gjatë këtij viti.

Pavarësisht këtyre vështirësive dhe problematikave, prokurorëve u është kërkuar në vijimësi zbatimin e drejtë dhe aplikimin e të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe i të gjitha parashikimeve ligjore të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, etj. Nga ana tjetër, është punuar për hartimin dhe nxjerrjen e rregullave standarde për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë me qëllim sigurimin e një organizimi, drejtimi dhe kontrolli efikas të punës, si dhe rritjen e pavarësisë së prokurorëve dhe nxitjen për kuptimin dhe zbatimin më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror.

Sipas urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm, për përgatitjen e raportit vjetor, paraqesim të dhënat si më poshtë:

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2021

- Informacion dhe masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të dala në zbatim të saj.
- Informacion dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Masat e marrë për luftën kundër korrupsionit;
- Masat e marrë në luftën kundër krimit të organizuar;
- Masat e marra për respektimin e të drejtave të njeriut;
- Masat e marra për respektimin e të drejtave të miturve dhe grupeve vulnerabël, si të pandehur dhe viktima;
- Masat e marra për rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Masat e marra për rritjen e përdorimit të metodave speciale hetimore dhe në hetimet proaktive;
- Problematikat e hasura gjatë vitit 2021.

➤ **Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre, etj.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ka qenë e angazhuar në marrjen e masave për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në zbatim të tyre, në lidhje me këto prioritete;

- *Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021”;*
- *Urdhërit Nr.103, datë 17.07.2020, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020”;*
- *Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave miratuar me vendimin Nr.501 datë 24.06.2020, “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”;*
- *Udhëzimi i Përgjithshëm Nr.11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”.*
- *Urdhëri Nr.112 datë 27.07.2020, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.*

- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 08 datë 04.12.2019 “Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar.*
- *Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr. 10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore nëprokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.*
- *Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori` të Prokurorit të Përgjithshëm.*
- *Udhëzimin nr. 55 prot datë 10.09.2018 ``Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale“*
- *Si dhe akte të tjera të dala në zbatim të tyre.*

i. Masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimeve prioritare të Këshilit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në bazë të tyre, etj

Menjëherë me marrjen dhe administrimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021», datë 14.06.2021, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 78, datë 09.07.2021 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, datë 14.06.2021 me shkresën me nr.977/3, datë 19.07.2021, nga Drejtuesi i Prokurorisë Prane Gjykates se Shkallës së Parë Kukës është bërë punimi dhe njohja e këtyre akteve pëe të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të kësaj prokurorie. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e kësaj Rezolute dhe janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në zbatimin e drejtëpërdrejtë të saj gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete që janë objekt dhe prioritet i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbledhjet, diskutimet e realizuara dhe udhëzimet e dhëna në vijim është mbajtur parasysh dhe është respektuar pavarësia e institucionit dhe e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në administrimin e materialeve hetimore dhe referuese dhe në kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara. Gjatë këtyre mbledhjeve dhe diskutimeve është vlerësuar nevoja e nxjerrjes ose jo të urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe të një plan veprimi në lidhje me Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë. Për këtë arsye, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është punuar Udhëzimi «Mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 »ku në vijim, ky udhëzim u është bërë i njohur dhe ju është shpërndarë nga një kopje të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës, duke u diskutuar edhe në mbledhjet dhe takimet e organizuara.

Ju është kërkuar prokurorëve që të garantojnë pavarësinë e tyre nga njëra anë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së tyre nga ana tjetër. Gjithashtu, janë nxitur në forcimin e rolit të tyre në fillimin e ndjekjes penale dhe forcimin e rolit aktiv në hetimet paraprake dhe në fillimin kryesisht të ndjekjes penale.

Gjithashtu, janë udhëzuar prokurorët për kontrollin periodik dhe efektiv të punës së oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës në lidhje me dosjet e deleguara prej tyre. Me qëllim kryerjen e hetimeve të plota dhe cilësore dhe shmangien e vonesave dhe zvarritjeve në përfundimin e hetimeve.

Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore u është kërkuar të angazhohen drejtëpërdrejtë në rritjen e tyre profesionale, në plotësimin e formularëve për trajnime dhe seminare dhe për pjesëmarrjen fizike të tyre ose online në trajnimet e realizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Drejtësisë dhe shoqatat e organizatat vendase dhe të huaja duke respektuar edhe fushat specifike ku ata kanë më shumë nevojë apo në raport me seksionet ku ata bëjnë pjesë.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar informacion në lidhje me çështje konkrete Objekt i Rezolutës së Kuvendit. Në rastet kur është vlerësuar se këto detyra dhe objektiva në procedimet penale konkrete janë komplekse, ka zvarritje apo vonesa dhe nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve konkrete është udhëzuar dhe rekomanduar kryerja me prioritet e detyrave të lëna. Në disa raste janë nxjerrë edhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për të cilat janë vlerësuar të domosdoshme apo rastet prioritet i Rezolutës së Kuvendit.

Në zbatim të Urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.164, datë 18.12.2020 « Për miratimin e rregulloreve standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm», nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar zbatimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Gjithashtu janë marrë masa për shpërndarjen dhe njohjen e saj për prokurorët, oficerët dhe nëpunësit e tjetër të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe marrjen e masave për zbatimin e këtyre ndryshimeve gjatë punës në Prokurori.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2020», datë 14.06.2021, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.78, datë 09.07.2021 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, datë 14.06.2021 », me shkresën me nr.977/3, datë 19.07.2021, nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar miratimi i planit të veprimit për masat administrative dhe procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2021, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2021”. Në vijim është bërë shpërndarja dhe njohja e këtij plani veprimi dhe zbatimin e tij nga të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, takimet dhe udhëzimet e dhëna janë diskutuar pikat e këtij plani veprimi, mënyra e zbatimit të tij dhe fazat e zbatimit. Gjithashtu, janë orientuar prokurorët dhe oficerët në zbatimin e drejtëpërdrejtë të tij gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje konkrete, detyrave administrative që janë Objekt dhe fokus i Rezolutës dhe urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në vijim të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020, «Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm», nga Drejtuesi i Prokurorisë është kërkuar zbatimi dhe rregullimi i marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës».

Masa konkrete janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në fazën e gjyqimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posacme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështje Objekt të Rezolutës.

Janë marrë masa dhe janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime edhe për oficerët e policisë gjyqësore në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera prej tyre, në lidhje me raportimet periodike për veprimet e kryera, si dhe për rritjen e cilësisë së relacioneve të çështjeve të përfunduara dhe shpejtësisë së përfundimit të tyre.

Gjatë vitit 2021, është nxitur bashkëpunimi i ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës dhe Komisariateve të Policisë Kukës dhe Has si dhe Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Shërbimeve të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, etj. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit. Gjithashtu, vijnë hetimet për një sërë procedimesh penale të referuara nga këto institucione në bashkëpunim mes këtyre shërbimeve të policisë gjyqësore.

Është synuar në zbatimin e masave të gjëra të shortit elektronik dhe përjashtimi i shortit (manual), vetëm në rastet kur prokurori ka qenë i gadshëm dhe ka patur masa sigurimi i është kaluar manualisht materiali, në rastet e zëvendësimit të prokurorëve apo në rastet e largimit, transferimit e pezullimit të prokurorëve, është mbajtur në funksion sistemi elektronik i ndarjes dhe menaxhimit të çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), duke bërë pasqyrimin e saktë në sistem të shortit dhe në vijim të fazave të tjera të procedimit penal. Gjithashtu, është kërkuar përgjegjshmëri në hedhjen dhe nxjerrjen e statistikave nga zyra e regjistrimit.

Një nga problematikat kryesore të konstatuara gjatë vitit 2021, ka qenë komandimi dhe lëvizja e prokurorëve në organikën dhe strukturën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ku nga organika një drejtues, një zv.drejtues dhe 3 prokurorë gjatë vitit 2021, kemi patur një drejtues, një zv. drejtues dhe një prokuror, fakt që ka ndikuar në ngarkesën në prokurori, në ngarkesën e çdo prokurori me dosje në hetim dhe gjykim, pamundësinë e kryerjes së një riorganizimi të plotë. Kjo ka ndikuar edhe në cilësinë e hetimeve, shpejtësinë dhe plotësinë e hetimeve dhe mundësinë e rritjes së efektivitetit dhe evadimit të dosjeve të mbartura në vitet e mëparshme, etj.

Një problematikë tjetër gjatë vitit 2021, ka qenë edhe vijimi i pandemisë Covid-19, e cila ka ndikuar drejtëpërdrejtë në punën e Prokurorisë. Ka ndikuar në efikasitetin në Prokurori. Gjithashtu, ka ndikuar në reduktimin e zhvillimit të mbledhjeve në vijimësi, qoftë të prokurorëve ashtu edhe mbledhjes së përgjithshme të prokurorisë. Kjo ka ndikuar edhe në pamundësinë e zhvillimit të takimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme, qoftë të problematikave të përgjithshme, qoftë edhe për çështje të caktuara e konkrete. Pamundësinë e zhvillimit të trajnimeve vazhduese në numër të mjaftueshëm gjatë vitit për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Ku edhe në mbledhjet e takimet e zhvilluara janë marrë masat e duhura për Covid-19, por janë shmangur zhvillimi i takimeve të plota dhe të gjithëanëshme. Fakte që kanë ndikuar në tërësi në punën dhe cilësinë e hetimeve dhe veprimeve hetimore të kryera deri tani.

Treguesit dhe indikatorët për rritjen e rolit të prokurorit në hetimet paraprahe.

Gjatë vitit 2021, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, në lidhje me veprat penale të rënda, apo ato Objekt i Rezolutës si dhe ato me ndjeshmëri të lartë shoqërore apo me interes për publikun janë nxitur dhe udhëzuar prokurorët dhe oficerët në kryerjen e hetimeve të plota dhe të thelluara, me qëllim hetimin e plotë të çështjeve penale konkrete apo në zbulimin dhe identifikimin formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale.

Gjatë këtij viti është rregjistruar 1 (një) procedim penal, me autor, për nenin 244 të K.Penal, i dërguar në gjyq dhe ndodhet në fazën e hetimit gjyqësor.

Janë mbartur 6 (gjashtë) procedime dhe janë rregjistruar edhe 12 (dymbëdhjetë) procedime penale për nenin 248 të K.Penal, ku nga këta procedime janë përfunduar hetimet për 3 (tre) procedime penale, ku 2 (dy) procedime janë transferuar dhe tre (tre) janë pushuar.

Në lidhje me këtë grup veprash, janë udhëzuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së hetimeve (realizimin e hetimeve proaktive), kryerjen e hetimeve të shpejta, si dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit, bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe agjencitë ligjzbatuese në realizimin e hetimeve sa më të plota, si dhe në ashpërsimin e qëndrimeve dhe të politikës penale si në caktimin e masave të sigurimit ashtu edhe në masën e dënimeve.

Një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e narkotikëve (nenet 283, 283/a/1, 284, etj), rezulton se gjatë këtij viti janë hetuar 22 procedime penale në lidhje me këto vepra, ku janë rregjistruar 16 (gjashtëmbëdhjetë) procedime penale të reja. Për veprën penale « Prodhimi dhe shitja e narkotikëve », të parashikuar nga neni 283 të K.Penal, janë hetuar 11 (njëmbëdhjetë) nga të cilat 5 të mbartura dhe 6 të rregjistruara këtë vit. Për veprën penale «Kultivimi i narkotikëve», të parashikuar nga neni 284 të K.Penal, janë rregjistruar 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale nga të cilat 10 rregjistruar gjatë këtij viti dhe një procedim penal i mbartur. Nga këto procedime, 6 (gjashtë) janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës, 3 (tre) janë dërguar me kërkesë për pushim, dhe 2 (dy) janë transferuar.

Për vitin 2021 nuk është referuar asnjë rast për veprën penale pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Gjatë të vitit 2021, rezulton se janë rregjistruar 4 (kater) procedime pasurore, në lidhje me referimet pasurore të ardhura. Janë mbartura 15 (pesëmbëdhjetë) procedime pasurore, 2 (dy) procedimeve pasurore janë transferuar, 1 (një) është mosfilluar dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) procedimet e tjera pasurore vijojnë të jenë në hetim. Duhet theksuar se ka një ulje të rasteve të referimeve pasurore në raport me vitin e kaluar. Gjithashtu për vitin 2021, nuk ka patur asnjë kërkesë për vendosje sekuestro dhe konfiskime.

Nga procedimet penale të regjistruara dhe hetuara gjatë vitit 2021, 19 (nëntëmbëdhjetë) procedime penale, janë hetuar me metodat speciale të hetimit, duke zhvilluar hetime proaktive (përgjime ambjentale dhe telefonike, vëzhgime, blerje e simuluar, e metoda të tjera speciale, etj), kryesisht në lidhje me vepra të rënda penale kundër jetës dhe shëndetit, në lidhje me narkotikët (prodhim, shitje, kultivim), shpërdorim detyrë, tregtimi dhe transportimi i mallrave kontrabandë, vrasje e mbetur në tentativë, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazot për tu mbrojtur etj. Në një pjesë të tyre këto veprime hetimore kanë dhënë rezultate të kënaqshme dhe në plotësimin e hetimeve, një pjesë e këtyre procedimeve janë dërguar për gjykim me akuzat përkatëse, ndërsa pjesa tjetër vijon të jetë në hetim. Vlen për tu theksuar se ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve penale për të cilat janë aplikuar metodat speciale të hetimeve, në raport me vitin 2020.

Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të përgjithshëm me Nr.17/2020 « Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje».

Në lidhje me Udhëzimin e Përgjithshëm me Nr. 17/2020 « Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje», janë marrë menjëherë masa për njohjen dhe shpërndarjen e tij për të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore. Në veçanti janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët e seksionit të krimeve kundër të miturve dhe dhunës në familje. Në lidhje me këto grup veprash penale është bërë një punë deri diku e kënaqshme në drejtim të sensibilizimit por edhe hetimit të këtyre veprave penale, kjo edhe në bashkëpunim me institucionet vendore dhe organizatat dhe shoqatat që operojnë në këto fusha.

Në lidhje me këtë udhëzim të përgjithshëm janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënien e asistimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet e tyre. Në këtë drejtim vlerësojmë se duhet të bëhet një punë më e madhe dhe një bashkëpunim më i ngushtë me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale apo Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve, oficerëve dhe koordinatorës së viktimave.

Gjatë vitit 2021, janë hetuar 2 procedime penale në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 121/a të K.Penal, ku të dy këto procedime janë dërguar në gjyq.

Në lidhje me veprat penale të braktisjes së të miturit apo keqtrajtimit të të miturit nenet 124 dhe 124/b të K.Penal, rezulton se janë rregjistruar 2 procedime penale, të cilat janë në fazën e hetimeve paraprake.

Në lidhje me veprat penale të dhunës në familje të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, rezulton se janë rregjistruar 18 (tetëmbëdhjetë) procedime penale, ndër të cilat janë dërguar për gjykim 7 (shtatë) procedime penale, ka përfunduar gjykimi për 5 (pesë) të pandehur të cilet janë deklaruar fajtor, dhe 2 (dy) procedime penale janë në fazën e hetimit gjyqësor.

Është kërkuar pushimi për 5 (pesë) procedimeve penale, në 1 rast është kërkuar vendosja e masës mjekësore.

Është kërkuar transferimi i 1 (një) procedimi penal, pasi autori i veprës penale ka qenë shtetas i huaj (Kosovar). Janë në fazën e hetimeve paraprake 4 (katër) procedime penale.

Në lidhje me këtë fakt një kujdes i veçantë është treguar në rastet e procedimeve penale me viktima të dhunës në familje të mitur dhe viktimave femra, në drejtim të sigurimit të kushteve dhe gjendjes sa më të përshtatshme për të dhënë deklaramë dhe paraqitur prova, si dhe shmangien e kontakteve të drejtëpërdrejta me shkelësit, më përjashtim të rasteve kur ballafaqimi ka qenë i domosdoshëm. Kryerja e intervistave dhe pyetjeve nga oficerë femra, si dhe në praninë e psikologeve dhe mbrojtësve ligjor femra në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.

Është synuar që pjesa dërmuese e rasteve të veprave penale të dhunës në familje, me bazë gjinore apo diskriminuese të hetohen nga prokurorët dhe oficerët e trajnuar të seksionit ndaj dhunës në familje dhe të miturve. Në rastet e veprave penale me të mitur kjo ka qenë për të gjitha procedimet. Vështirësi është hasur për shkak të numrit të vogël të prokuroëve, problemeve të gadishmërisë dhe në këto raste, çështja është hetuar me grup hetimor ku së paku një nga prokurorët ka qenë pjesë e seksionit të dhunës në familje dhe të miturve.

Në të gjitha këto procedime, është synuar hetimi në një kohë sa më të shkurtër, kjo edhe në varësi të bashkëpunimit të institucioneve të tjera në paraqitjen dhe marrjen e provave, kjo duke synuar në sigurimin në të gjitha rastet të të drejtave dhe garancive procedurale për viktimat e dhunës në familje, me bazë gjinore apo e viktimave të mitur.

Edhe për sa i përket masave dhe llojit të dënimit në këto raste, janë udhëzuar prokuroret dhe është synuar në mbajtjen e dënimeve në mbi mesataren e marzheve të dënimit por duke pasur parasysh edhe rrethanat personale apo lehtësuese e rënduese të autorëve të vepres penale apo raportet me viktimat e veprave penale.

Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm me Nr.8/2020 « Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm » dhe Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 «Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020, për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm».

Në lidhje me udhëzimin e përgjithshëm me Nr.8/2020 «Për shpenzimet procedurale penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm», i ndryshuar më pas me udhëzimin e përgjithshëm me nr.06, datë 23.07.2021 «Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.08, datë 19.05.2020, për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm». Në vijimësi nga viti i kaluar kur është administruar urdhëri i parë janë marrë masat e duhura për shpërndarjen dhe njohjen me këto urdhëra të prokurorëve dhe zyrës së financës në lidhje me mënyrën e kuptimit dhe zbatimit të tyre. Në veçanti janë organizuar mbledhje dhe konsultime me prokurorët dhe oficerët dhe zyrën e financës në lidhje me mënyrën e evidentimit të shpenzimeve dhe mënyrën e pagesës së ekspertëve të ndryshëm, psikologëve dhe mbrojtësve të caktuar kryesisht, etj.

Janë udhëzuar prokuroret për mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve të shpenzimeve procedurale dhe në lidhje me nxjerrjen e urdhërave për pagimin e këtyre shpenzimeve. Gjithashtu, prokurorët janë udhëzuar në evidentimin e saktë të të gjitha shpenzimeve, qoftë atyre të parapaguara nga shteti, ashtu edhe atyre që paguhen në vijimësi, në mënyrë që në përfundim të hetimeve procesverbalet të jenë të plota dhe të sakta dhe ato të evidentohen saktë në regjistrin e shpenzimeve procedurale.

Në disa raste është hasur në vështirësi, qoftë në lidhje me rastet e ekspertimeve apo ekspertizave të cilat nuk kanë evidenca të sakta të vlerave apo rastet e ekspertimeve komplekse apo të posacme, ku në këto raste ekspertët kanë paraqitur fatura tej vlerave të ekspertimeve të ngjashme dhe në këto raste janë udhëzuar prokurorët në diskutimin dhe aritjen e një marrveshje me ekspertët në saktësimin e këtyre vlerave të ekspertimeve duke u orientuar drejt masave të pagesave të ekspertimeve të ngjashme apo të përafërta.

Vështirësi është hasur në rastet e përkthyesve të licensuar kryesisht të gjuhës arabe si dhe të gjuhëve të tjera. Po kështu problematikë kemi hasur dhe në rastet e ekspertimeve kontabël komplekse, vlerësuese, kompjuterike, dhe ekspertimeve autoteknike me disa ekspertë . Ku në këto raste ekspertët kanë kërkuar pagesa të larta duke paraqitur pretendime për volumin e akteve apo provave, kompleksitetin e çështjes, orët e punës së kryera apo numrin e ekspertëve që kanë kryer punën pjesërisht apo plotësisht të pavarur si dhe pretendimet e tyre për largësinë kilometrike pasi në rrethin tonë nuk ka ekspert të këtyre fushave.

Gjithashtu, në rastet e përkthyesve të gjuhëve të huaja, për të cilat kanë pak përkthyes apo vështirësi në përkthim, sic janë rastet e dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit apo trafikimit të qënieve njerzore, të shtetasve, Sirianë, Afganë, Iranianë, apo nga vende të

afrikës, përvec faktit të vështirësisë së gjetjes së përkthyesve të këtyre gjuhëve ka pasur problematika edhe për vlerën e pagimit të tyre dhe mënyrën e pagimit për shkak të problematika të rregjistrimit dhe dokumentacionit tatimor të këtyre përkthyesve dhe në vijim refuzimit të tyre për të kryer detyrën në raste të tjera kur nevojitej përkthimi nga ana e tyre.

Vështirësi është hasur edhe në dokumentimin e shpenzimeve të kryera në terren për shkak të mungesës së standartizimit të tyre, në rastin e kqyerjeve të ndryshme, të vendeve apo objekteve, në kryerjen e eksperimenteve apo ekspertizave të ndryshme, etj.

Më e thjeshtë dhe më e qartë ka qenë evidentimi i mbrojtjes kryesisht dhe i ndihmës juridike falas pasi edhe legjislacioni dhe aktet nënligjore janë më të plota dhe më të përcaktuara e standarte.

Gjithashtu, është synuar në standartizimin e kohës së evidentimit dhe pagimit të shpenzimeve dhe akteve që duhet të nxirren për kryerjen e pagesave, që nga procesverbalet e evidentimit, urdhërat për kryerjen e pagesave dhe faturat tatimore që duhet ti bashkëlidhen urdhërave, të dërguara për veprim në zyrën e financës dhe rregjistrimin e tyre prej saj dhe kryerjen e pagesave sipas parashikimeve ligjore dhe tatimore.

Është orientuar zyra e financës për kalimin vetëm të urdhërave të pagesave që kanë njëkohësisht nënshkrimet e prokurorit të çështjes dhe të drejtuesit të prokurorisë.

Në rastet e veprave penale të filluara mbi ankimit e të dëmtuarit dhe është vendosur pushimi i çështjes për shkak se fakti nuk ekziston apo i dëmtuari ka hequr dorë nga ankimi, janë orientuar prokurorët që pagimi i shpenzimeve ti ngarkohet ankuesit.

Nuk ka pasur raste të kërimit paraprakisht të sekuestrimit të pasurisë së të pandehurit në rastet kur ka pasur dyshime në mundësinë apo vullnetin e tij në pagimin e shpenzimeve, kjo është bërë edhe për të shmangur çdo pretendim për paragjykim apo njëanëshmëri në çështje.

Në të gjitha çështjet e përfunduara, të dërguara në gjyq, të pushuara, të pezulluara, janë evidentuar dhe nxjerrë procesverbalet e shpenzimeve procedurale dhe në vijim janë nxjerrë edhe urdhërat e pagimit dhe gjithashtu është proceduar me pagimin e ekspertëve që kanë paraqitur rregullisht dokumentacionin ligjor.

Në lidhje me pagimin e shpenzimeve pasi vendimi penal ka marrë formë të prerë, janë udhëzuar prokurori i ekzekutimeve dhe prokurorët e tjerë në evidentimin e saktë të shpenzimeve dhe dërgimin e urdhërave të ekzekutimit në kohë në zyrën e përmbarimit dhe në marrjen e masave të tjera ligjore për të bërë të mundur pagimin e shpenzimeve dhe ekzekutimin e të gjitha detyrimeve financiare nga personat e dënuar dhe të parapaguara nga shteti.

Të dhëna në lidhje me procedimet penale të rregjistruara për veprat penale të dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe veprat penale me të mitur.

Në lidhje me procedimet penale me persona të mitur të përfshirë, rezulton se janë regjistruar gjatë këtij 9 mujori (dyzet) referime penale, dhe 2 procedime penale të mbartura nga viti 2020, me persona të mitur, si të mitur në konflikt me ligjin 32 procedime penale dhe të mitur viktime 10 (dhjetë) procedime penale. Nga këto në 15 (pesëmbëdhjetë) raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Në kato çështje 10(dhjetë) procedime janë pushuar pasi është marrë masa e shmangies nga përgjegjësia penale për të miturit. Janë dërguar në gjyq 6 (gjashtë) procedime penale. Në hetim janë 9 procedime penale.

Pjesa më e madhe e të miturve në konflikt me ligjin janë moshës 14-17 vjec (25 persona). Në lidhje me gjininë 100 % e të miturve në konflikt me ligjin janë meshkuj dhe femra nuk ka. Nga ana tjetër në lidhje me viktimat e mitura 70 % e tyre janë femra dhe vetëm 30% janë meshkuj.

Vlen të theksohet se referimet e këtyre grupveprave janë relativisht të dobëta dhe nga ana tjetër haset në vështirësi në gjetjen dhe sigurimin e provave që provojnë veprën penale dhe fajësinë e autorëve, kjo edhe për shkak të mosbashkëpunimit të duhur të viktimave të këtyre veprave penale.

Në lidhje me veprat penale të shfrytëzimit të prostitucionit etj, gjatë këtij 9-mujori rezulton se nuk kemi pasur raste në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Në lidhje me veprat penale të dhunës në familje dhe me bazë gjinore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës , nuk kemi patur asnjë rast gjatë vitit 2021.

Analizat, trajnimet, bashkëpunimet dhe marrëdhëniet juridiksionale.

Gjatë vitit 2021, në lidhje me procedimet e këtij viti rezulton se nuk është kërkuar dhe nuk është vendosur masa e sekuestros pasurore «Sekuestro preventive» mbi pasuritë e personave të dyshuar dhe gjithashtu nuk është kërkuar konfiskimi i pasurive në lidhje me procedimet pasurore të rregjistruara. Aktualisht për procedimet pasurore të rregjistruara në vitet e mëparshme dhe ato të rregjistruara në vitin 2021, vijojnë të jenë në hetim. Kërkohej një mbështetje dhe nxitje më e madhe për prokurorët në lidhje me aplikimin dhe zbatimin e masave të sekuestrove preventive në lidhje me këto procedime. Ngarkesa me çështje në hetim dhe në gjykim, vështirësitë në kryerjen e këtyre hetimeve dhe domosdoshmëria e kryerjes së veprimeve dhe hetimeve voluminoze kanë ndikuar edhe në mungesën e rezultateve në këtë drejtim.

Gjatë këtij viti nuk janë rregjistruar procedime penale të reja në lidhje me veprat penale në fushën e terrorizmit. Në lidhje me këto grup veprash penale nuk ka pasur raste të sekuestrimit apo konfiskimit të pasurive apo asetëve kriminale të financimit të terrorizmit apo produkteve të veprës penale, për vetë numrin e çështjeve dhe natyrën e tyre.

Për vitin 2021, rezulton se nuk ka pasur referime dhe procedime penale të rregjistruara mbi bazën e referimeve apo kallëzimeve penale të ILDKPKI.

Gjatë vitit 2021 është synuar të mbahet një bashkëpunim të ngushtë dhe efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës dhe Komisariatet, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, , me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, etj. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit.

Në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë rezulton se gjatë vitit 2021, Janë dërguar 14 (katërmëdhjetë) kërkesa për ekzekutim të letërporosive për jashtë shteti, nga të cilat gjysma e tyre janë ekzekutuar, ndërsa nuk ka vendime për pranimin dhe ekzekutimin e pjesës tjetër të kërkesave.

Janë administruar 25 (pnjëzet e pesë) kërka për ekzekutim të letërporosive nga jashtë shteti, nga të cilat 23 (njëzet e tre) janë ekzekutuar dhe 2 (dy) nuk është bërë e mundur ekzekutimi i tyre për faktin se leterporosia nga jashtë ka ardhur në fundin e vitit 2021.

Kështu janë dërguar 27 (njëzet e shtatë) kërkesa për ekstradime personash nga jashtë shtet ku për pjesën më të madhe të tyre janë përfunduar procedurat e ekstradimit.

Ka 1 kërkesë për njohje të vendimit penal të huaj, në proces ekzekutimi dhe 1 (një) kërkesë për ekzekutim të vendimeve penale në shtet të huaj.

Në mbledhjet, takimet dhe analizat e zhvilluara me shërbimet e ndryshme të policisë gjyqësore dhe me drejtuesit e këtyre policive është kërkuar dhe nxitur përmirësimi i punës me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, krijimin e grupeve hetimore efektive në rastin e hetimeve të veprave të rënda penale, komplekse apo me numër të madh veprimesh.

Plotësimi i organikës dhe strukturës së prokurorisë kryesisht me prokurorë (për shkak të shkarkimit nga vetingu jemi në mungesë), gjithashtu në lidhje me oficerët e policisë gjyqësore jemi në mungesë, si dhe shtimi dhe trajnimi i tyre dhe i administratës, sidomos sekretar operator arkivist, do të sillte një përmirësim të ndjeshëm të punës dhe cilësisë së akteve dhe hetimeve penale në të ardhmen.

Gjatë vitit 2021, të gjithë prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur seminare dhe trajnime në lidhje me aplikimet e bëra më parë prej tyre në Shkollën e Magjistraturës apo institucione të tjera, ku në pjesën më të madhe kanë qenë trajnime online. Kjo ka ndodhur për një periudhë për shkak të pandemisë Covid-19. Aktualisht kanë vijuar pjesëmarrjen në trajnimet online sipas profileve të punës së tyre në seksionet ku bëjnë pjesë apo për seminare të vlerësuara sipas nevojës së tyre dhe aplikimeve të bëra në Shkollën e Magjistraturës, trajnimeve të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë apo nga shoqata dhe organizata vendase apo të huaja.

Vlerësojmë se zhvillimi apo shtimi i trajnimeve në fushën e dispozitave të reja penale dhe procedurale, të dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, në lidhje me hetimin e veprave penale «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale» dhe «Korrupsionit» apo «Shpërdorimit të detyrës», apo në fusha të tjera të ngjashme, do të sillte një përmirësim të dukshëm në përmirësimin e mënyrës së hetimit të këtyre grup veprash dhe në cilësinë e hetimeve. Nga ana e Drejtuesit janë sugjeruar prokurorët dhe oficerët që të plotësojnë formularët e trajnimeve vazhduese duke zgjedhur terna në lidhje me këto grup veprash në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri me metodat dhe praktikat e reja më të mira të hetimit të tyre.

Organizimi i seminareve dhe trajnimeve në vijimësi në të gjitha fushat penale dhe procedurale penale, sidomos në fushat apo institutet e reja si dhe ato të drejtësisë penale për të mitur, të prokurorëve ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore vlerësohet e domosdoshme me qëllim rritjen e performancës së punës, rritjen e cilësisë së akteve dhe veprimeve hetimore, si dhe në kryerjen e hetimeve të shpejta dhe cilësore dhe garantimin e të drejtave procedurale të të gjitha subjekteve të procedimit penal.

Në vijimësi nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masat e duhura administrative dhe procedurale në lidhje me zbatimin e planit të veprimit dhe evidentimin e ecurisë së zbatimit të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë.

Masat e marra dhe udhëzimet e dhëna në vijimësi kanë synuar jo vetëm zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe urdhërit nr. 78/2021 të Prokurorit të Përgjithshëm por edhe në realizimin e një unifikimi të veprimtarisë administrative dhe procedurale dhe rritjen e performancës së punës së Prokurorisë, si dhe përballjen me tendencat dhe format e reja të shfaqjes së kriminalitetit në vendin tonë dhe mbrojtjen e viktimave të këtyre veprave penale.

ii. Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të produkteve të veprave penale dhe krimit financiar...

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, në lidhje me veprat penale objekt i Rezolutës, si veprat e rënda penale, ato me ndjeshmëri të lartë shoqërore janë nxitur dhe udhëzuar prokurorët dhe oficerët në kryerjen e hetimeve të plota dhe të thelluara, me qëllim hetimin e plotë të çështjeve penale konkrete apo në zbulimin dhe identifikimin formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale.

-Është hetuar 1(nje) procedim penal në lidhje me veprën penale të « Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike » parashikuar nga neni 244/1 i K.Penal, i cili është dërguar në gjyq dhe është dënua sipas nenit 59 të Kodit Penal.

-Ndërsa në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, rezulton se janë rregjistruar 23 (njëzet e tre) procedime penale, nga të cilat 6 (gjashtë) procedime penale janë të mbartura dhe 17 janë regjistruar gjatë këtij viti. Për 6 (gjashtë) procedime penale është paraqitur kërkesë për pushimin e çështjes dhe është kërkuar pushimi për shkaqe të tjera, për 1 (një) procedim penal është marrë vendim për shpallje moskompetence, 1 (një) është dërguar në gjyq me një të pandehur, ndërsa vijojnë hetimet për 15 (pesëmbëdhjetë) procedime penale të tjera.

-Gjithashtu për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, rezulton se për vitin 2021 janë regjistruar ne total 21 (njëzet e një) kallzime penale dhe për 4 (katër) kallzime penale dhe është marrë vendim mosfillimi të procedimit penal.

-Gjatë të vitit 2021, rezulton se janë rregjistruar 4 (kater) procedime pasurore, në lidhje me referimet pasurore të ardhura. Jane te mbartura 15 (pesëmbëdhjete) procedime pasurore, 2 (dy) procedimeve pasurore jane transferuar, 1(një) eshte mosfilluar dhe 16(gjashtëmbëdhjetë) procedimet e tjera pasurore vijojnë të jenë në hetim.

-Nga procedimet penale të hetuara gjatë vitit 2021, 13 (trembëdhjetë) procedime penale, janë hetuar me metodat speciale të hetimit, duke zhvilluar hetime proaktive (përgjime ambjentale e telefonike, vëzhgime, blerje e simuluar, e metoda të tjera speciale, etj), kryesisht në lidhje me vepra të rënda penale kundër jetës dhe shëndetit, në lidhje me narkotikët, në lidhje me shpërdorimin e detyrës në lidhje me marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për tu mbrojtur, tregtimi dhe transportimi i mallrave kontrabandë, etj. Nga këto 1 (një) procedim penal i mbartur nga vitet e mëparshme dhe 12 (dymbëdhjetë) procedime penale janë procedime të reja të rregjistruara gjatë vitit 2021. Në një pjesë të tyre këto veprime hetimore kanë dhënë rezultate të kënaqshme dhe në plotësimin e hetimeve. Janë dërguar për gjykim 5 (pesë) procedimeve penale me akuzat përkatëse, 1 (një) është pushuar, ndërsa 7 (shtatë) vijojnë të jenë në hetim.

Vlen për tu theksuar se, pamvarësisht numrit më të ulët të përgjithshëm të procedimeve penale të rregjistruara dhe problematikave të dala gjatë këtij viti ka një rritje të numrit të procedimeve penale për të cilat janë aplikuar metodat speciale të hetimeve në raport me një vit më parë (10 procedime penale të hetuara me metoda speciale gjatë vitit 2020), kjo për shumë arsye qoftë objektive dhe subjektive. Kjo tregon një vullnet dhe qëllim të mirë të prokurorëve jo vetëm në respektimin e prioriteteve të Rezolutës së Kuvendit, Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave si dhe të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm por edhe synimit të prokurorëve në kryerjen e hetimeve sa më të plota dhe rritje të bashkëpunimit me policinë e shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese. Këto kërkesa në pjesën më të madhe janë mbështetur nga gjykata me vendime për lejimin e përgjimeve apo të vëzhgimeve dhe në më pak raste janë rrëzuar prej saj. Vendime që kanë orientuar prokurorët dhe policinë gjyqësorë në përgatitjen e materialeve kallëzuese dhe referimeve më

të plota dhe më të mbështetura në prova dhe në vijim në paraqitjen e kërkesave më serioze dhe më të plota në prova dhe më të arsyetuara.

Vlerësojmë se zhvillimi apo shtimi i trajnimeve në fushën e «Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale» dhe «Korrupsionit» apo «Shpërdorimit të detyrës», apo në fusha të tjera të ngjashme, do të sillte një përmirësim të dukshëm në përmirësimin e mënyrës së hetimit të këtyre grup veprash dhe në cilësinë e hetimeve. Drejtuesi i Prokurorisë në vijimësi u ka sugjeruar prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që të plotësojnë formularët e trajnimeve vazhduese duke zgjedhur tema në lidhje me këto grup veprash në mënyrë që të marrin trajnime dhe njohuri e duhura me metodat dhe praktikatat e reja më të mira të hetimit të këtyre grup veprave penale.

Në mbledhjet, takimet dhe analizat e zhvilluara me shërbimet e ndryshme të policisë gjyqësore dhe me drejtuesit e këtyre policive është kërkuar dhe nxitur përmirësimi i punës me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, krijimin e grupeve hetimore efektive në rastin e hetimeve të veprave të rënda penale, komplekse apo me numër të madh veprimesh.

-Është siguruar dhe janë nxjerrë të dhëna qoftë manuale dhe elektronike duke realizuar plotësimin në kohë me të dhënave dhe rregjistrave elektronik dhe manual për shortimet, verifikimet dhe procedimet penale. Gjithashtu është raportuar në mënyrë periodike në Sektorin e Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

-Gjatë vitit 2021, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë ndjekur pjesërisht seminare dhe trajnime në lidhje me aplikimet e bëra më parë. Në muajt e parë të vitit ato kanë qenë sipas parashikimeve të bëra, ndërsa në vijim ka patur vështirësi në ndjekjen e seminareve dhe trajnimeve. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të pandemisë Covid-19 dhe gjendjen së përgjithshme shëndetësore dhe kufizimeve të ndryshme. Në pjesën e dytë të vitit është vijuar me pjesëmarrjen në trajnimet online sipas profileve të punës së prokurorëve dhe oficerëve ose sipas aplikimeve të bëra më parë prej tyre si dhe ato të vlerësuara sipas nevojës së secilit prej tyre dhe aplikimeve të bëra në Shkollën e Magjistraturës, trajnimeve të organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë apo nga shoqata dhe organizata vendase dhe të huaja.

iii. Masat e marra në drejtim të rritjes së efijencës në lidhje me masat e sigurimit dhe masat e dënimit lidhur me veprat penale të dhunës në familje, kundër fëmijëve dhe grave, etj.

Në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2021», datë 14.06.2021, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.78, datë 09.07.2021 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 14.06.2020», si dhe të udhëzimit Nr.5/2018 «Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale», në vijimësi janë organizuar mbledhje e diskutime dhe janë dhënë udhëzime jo vetëm me njohjen me këto akte por, edhe me zbatimin në praktikë të udhëzimit dhe dhënies së asistencës dhe mbështetjes së viktimave të veprës penale apo edhe dëshmitarëve. Në lidhje me këtë udhëzim janë orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe psikologët dhe koordinatorja e viktimave në dhënie të asistencës, këshillimit dhe ndihmës ligjore dhe psikologjike gjatë kontakteve, pyetjeve dhe në intervistimet me viktimat e këtyre veprave por edhe në rastin e personave nën hetim apo të pandehurve të mitur, etj.

-Në këtë drejtim vlerësoj se seksioni për të miturit me një prokurorë dhe një oficerë si dhe me stafin ndihmës kanë bërë një punë të mirë në drejtim të orientimit dhe ndërgjegjësimit të subjekteve të tjera procedurale dhe ndihmësi, si dhe në rritjen e bashkëpunimit me subjektet e tjera procedurale, me strukturat përkatëse pranë bashkive si dhe me shoqatat e mbrojtjes së viktimave të veprave penale, të dhunës në familje apo Njësisë për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës, etj.

-Mbrojtja e të drejtave e të miturve në procesin penal, si dhe e grupeve të tjera vulnerabël ka qenë dhe mbetet një sfidë për tu realizuar. Parashikimet e ligjit Nr.37, viti 2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, kanë nxjerrë detyra dhe problematika të reja për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore dhe implementimi i plotë të këtij ligji, i akteve të tjera dhe institucioneve të reja mbetet një sfidë për tu realizuar dhe duhet pranuar që në këtë drejtim po punohet me seriozitet por, përsëri mbetet shumë për tu bërë nga të gjitha palët.

Në vijimësi, janë udhëzuar dhe orientuar prokurorët dhe oficerët jo vetëm në zbatimin e parashikimeve ligjore por edhe në zbatimin dhe përqëndrimin edhe në urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm “*Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person nën hetim, i dëmtuar, viktimë e vepres penale ose edhe si dëshmitar*”, duke siguruar pjesëmarrjen e psikologut gjatë hetimit, si asistues i të miturit ashtu edhe në kryerjen e raportit psikologjik për të miturin gjatë hetimeve, si dhe është orientuar në drejtim të ruajtjes së sekretit të informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore dhe provave të mbledhura nga policia gjyqësore, në rastet e hetimeve në ngarkim të pandehurve të mitur.

-Gjatë këtij viti janë rregjistruar 45 (dyzet e pesë)kallëzime penale me të mitur, nga këto janë regjistruar 25 (njëzet e pesë) procedime penale, 12 procedime penale janë dërguar për gjykim në Gjykatë dhe 13 procedime penale janë marrë vendime për shmangien e të miturit nga procedimi penal, 6 procedime janë në hetim dhe për 14 kallëzime është vendosur mosfillim. Në të gjitha rastet është synuar shmangia e masës së sigurimit «arrest në burg» për personat e dyshuar të mitur pasi, në asnjë rast nuk është aplikuar kjo masë sigurimi me arrest në burg.

-Në procedimet me të mitur në të gjitha rastet është realizuar pyetja apo kryerja e veprimeve të tjera hetimore në prani të psikologut, të përfaqësuesit ligjor dhe të mbrojtësit të zgjedhur apo të caktuar kryesisht. Në këto procedime si dhe ato me të mitur viktimë e vepres penale janë marrë vendimet për kryerjen e raporteve të vlerësimit psikologjik dhe janë administruar raportet përkatëse nga ekspertët psikologë apo specialistët e ZVSHP para përfundimit të hetimeve dhe marrjes së vendimit përfundimtar për shmangie, për pushim apo për dërgimin në gjykim.

-Asistenca e duhur ndaj grave të dhunuara, të miturve dhe viktimave të tjera të veprave penale është arritur edhe në sajë të bashkëpunimit me institucionet e tjera, me shoqatat dhe në sajë të marrëveshjeve me drejtoritë përkatëse të krijuara pranë Bashkive. Është synuar në drejtim të kryerjes së veprimeve hetimore duke shmangur riviktimizimin e tyre, krijimin e një ambjenti të përshtatshëm gjatë marrjes në pyetje apo kryerjes së veprimeve të tjera dhe shmangien e ripyetjeve të tyre për aq sa ka qenë e mundur.

-Gjithashtu, është kërkuar kryerja e veprimeve të shpejta hetimore në rastin e hetimeve me persona të mitur të dyshuar por edhe në rastet kur kanë qenë në pozitën e viktimave të vepres penale. Duhet thënë që pjesa më e madhe e procedimeve janë përfunduar në afate të shkurtra 1-2 ose 3 mujore duke respektuar detyrimet ligjore përkatëse.

-Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur qoftë si persona nën hetim, si të pandehur ashtu edhe si viktima të vepres penale është synuar gjithmonë në drejtim të

respektimit të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve, duke respektuar të gjitha garancitë e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore. Janë nxitur dhe orientuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në ndërgjegjësimin e tyre në drejtim të respektimit të këtyre të drejtave dhe ofrimit të të gjitha garancive ligjore që në fazën e hetimeve të para e në vijim, si dhe gjatë gjykimit të këtyre veprave penale.

-Në lidhje me veprën më të përhapur përsa i përket këtyre grupveprave, vepra penale e "Dhunës në familje" parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, gjatë këtij viti janë hetuar 21 (njëzet e një) procedime penale, të mbartura 9 procedime penale. Nga këto procedime penale 19 (nëntë mbëdhjetë) janë dërguar për gjykim me 19 të pandehur me 11 persona të arrestuar, 9 procedime janë pushuar, 1 është transferuar, dhe një është në hetim.

-Në lidhje me masat e sigurimit në lidhje me këto vepra penale është synuar në drejtim të ashpërsimit të politikës penale dhe kërkimit të masave të ashpra të dënimit. Në mbi 50 % e rasteve të referuara rezulton se janë aplikuar arrestet në flagrancë apo ndalimet sipas rastit. Gjithashtu, në kërkimet e prokurorisë në pjesën më të madhe është kërkuar masa e sigurimit "arrest në burg" në rastet e veprave penale të parashikuara nga nenet 101/1, 108/1, 108/4, 121/a/1, 121/a/3 130/a/1, 130/a/2, 130/a/3, 130/a/4, etj, të Kodit Penal duke vlerësuar edhe rrethanat e ngjarjeve dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Edhe nga ana e gjykatës në pjesën më të madhe të rasteve kanë mbështetur kërkimet e prokurorëve. Vlen për tu theksuar se janë disa raste të procedimeve penale të filluara nga referimet e paraqitura nga gjykata në rastet e gjykimit të kërkesave për lëshimin e urdhërave të menjëhershëm të mbrojtjes apo të miratimit të urdhërave të mbrojtjes.

-Gjithashtu, nga ana tjetër në rastet e hetimit të veprave penale në marrëdhëniet familjare «Vepra të turpshme», «Përndjekje», « Dhunë në familje », apo në lidhje me krimet seksuale dhe kundër moralit është kërkuar aplikimi i masave të ashpra të sigurimit, sigurimi i një mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e këtyre veprave penale dhe zbatimi i një politike penale të ashpër për autorët e këtyre veprave penale.

-Edhe në lidhje me masat e dënimit për këto vepra penale në fazën e gjykimit janë aplikuar masa relativisht të ashpra dënimesh. Në pjesën më të madhe të tyre janë kërkuar dënime me burgim dhe mbi mesataren që parashikon dispozita penale konkrete. Këto kërkesa kanë gjetur mbështetje edhe nga gjykata duke dhënë dënime me burgim për dhunuesit në një pjesë të madhe të çështjeve të gjykuara.

-Gjatë vitit janë konstatuar se veprimet e para hetimore, asistenca në momentin e parë nuk ka qenë në nivelin e duhur, fakt që ka bërë edhe dëmtimin e hetimeve dhe cënimin e tyre në raste të caktuara për vetë natyrën e këtyre veprave penale dhe gjendjen vulnerabël të viktimave. Në këtë drejtim duhet të bëhet një punë më e mirë, duke plotësuar seksionet përkatëse në komisariate dhe trajnimin e duhur të oficerëve të komisariateve si dhe mundësinë e pjesëmarrjes së psikologëve të bashkive apo të kordinatorëve e asistuesve që në momentin e parë që viktimat e këtyre veprave penale paraqiten për kallëzim në ambjentet e komisariateve të policisë.

iv. Masat e marra për rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe forcimin e koordinimit me Prokurorinë e Posaçme të Luftës Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

Në zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë «Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019», datë 18.06.2020, si dhe të urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.103, datë 17.07.2020 «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020», si dhe «Aktit të koordinimit ndërinstitucional » ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar me datë 05.12.2020, janë marrë masa në vijimësi për rritjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe rritjen e komunikimeve përsa i përket shkëmbimeve të informacioneve për procedimet reciproke me interes të përbashkët apo edhe të njëanshëm.

Duhet pranuar se në lidhje me zbatimin e Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional për shkak të kohës së shkurtër të implementimit të tij nuk ka pasur një rezultat të prekshëm. Nga ana tjetër gjatë këtij viti ka pasur një numër të caktuar rastesh të transferimeve të materialeve hetimore apo procedimeve.

-Gjatë vitit 2021, janë 3 (tre) procedime penale të ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Posaçme për kompetencë, në lidhje me këto raste të treja janë në fazën e hetimit.

-Nga ana jone 1 (një) procedim penal është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme, në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 301, 312 të K.Penal. Ky procedim penal është kthyer përsëri nga ana e SPAK dhe është vijuar përsëri hetimi, ku është bërë ndryshimi i cilësimit të veprës penale dhe është paraqitur kërkesë për pushim në gjykatë, për veprën penale parashikuar nga neni 301 i kodit Penal.

Edhe në vijim vlerësojmë se bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme do të vijë në rritje, si në zbatim të «Aktit të koordinimit ndërinstitucional » ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me nr.8126, miratuar me datë 05.12.2020, por gjithashtu për shkak të procedimeve penale të lidhura si dhe faktit të hetimet të çështjeve për vepra penale në kompetencë të të dy prokurorive.

v. Masat e marra dhe rezultatet e treguesit në zbatimin e urdhërit penal, marrëveshjet e pranimit të fajësisë dhe gjykimit të drejtëpërdrejtë dhe dënimet alternative:

Puna dhe detyrat e prokurorëve dhe e oficerëve të policisë gjyqësore edhe gjatë vitit 2021 është orientuar dhe nxitur që të kryhet në përputhje të plotë dhe në respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo duke pasur parasysh të parimet themelore të legjislationit penal dhe proceduralo penal. Është synuar drejt kryerjes së hetimeve të shpejta dhe sa më të plota, duke pasur parasysh edhe vështirësitë e krijuara nga mungesat në strukturën e prokurorisë dhe policisë, vonesat në marrjen e përgjigjeve nga institucione të ndryshme dhe mungesat e ekspertëve të fushave të ndryshme, gjendja e pandemisë, etj.

a) Gjatë këtij viti janë dërguar në gjykatë 58 (pesëdhjetë e tetë) procedime penale janë dërguar në gjykatë me urdhër penal, ku nga Gjykata janë miratuar 51 urdhëra penal. Këto kërkesa janë për veprat penale «Mosbindje ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik » dhe « Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror » të parashikuara nga nenet, 242 dhe 297 të Kodit Penal. Këto urdhëra në 51 (pesëdhjetë e një) raste janë miratuar nga Gjykata

dhe 7 (shtatë) raste është refuzuar miratimi. Megjithëse u është kërkuar dhe janë nxitur prokurorët në aplikimin e këtij instituti kjo mangësi vlerësoj se nuk ka ardhur kryesisht për neglizhencë por për shkak të qëndrimit apo sjelljes së të pandehurve apo edhe mosplotësimin të kushteve të tjera ligjore.

b) Gjatë vitit 2021, nga ana e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, janë përfunduar hetimet dhe janë dërguar në gjykatë 8 procedime penale me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë së të pandehurit dhe caktimin e dënimit, kryesisht këto në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 137, 199/a/1, 242, 277, 290/1, 291 të K.Penal. Në pjesën dërmuese të tyre këto marrëveshje janë pranuar nga gjykata, vetëm për një rast 1 (një) rast është refuzuar nga gjykata për mos paraqitje të të pandehurit.

c) Gjithashtu, 5 (pesë) procedime penale janë dërguar në gjykatë me procedurën e gjyqimit të drejtëpërdrejtë, për të cilat gjykata ka vendosur pranimin e tyre për të proceduar me gjykim të drejtëpërdrejtë pamvarësisht qëndrimit të mbajtur për vlerësimin e arresteve dhe masën e sigurimit. Kryesisht ky institut është aplikuar në rastet e vepres penale të parashikuara nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim, për 160 raste është kërkuar nga prokurori aplikimi i dënimeve alternative nenet 59 dhe për dy raste për nenin 63 të K.Penal, kjo duke pasur parasysh natyrën e vepres penale, rrezikshmërinë e pakët të vepres penale dhe rrezikshmërinë e pakët të autorit, personalitetin e tij dhe rrethanat lehtësuese. Aplikimi i dënimeve alternative është kërkuar në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të vogël si ato të parashikuara nga nenet 187/1, 137, 199/a/1, 275, 277, 291, 297, 298/1, 293/3, 323 etj të Kodit Penal.

Përsa i përket veprave penale që prekin zgjedhjet e lira, rezulton se për vitin 2021 nuk janë rregjistruar procedime penale të reja në lidhje me këto vepra penale.

vi. Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 04/2021 lidhur me rekomandimet prioritare “Për ... në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021”, etj.

Menjëherë pas marrjes dhe administrimit të «Rekomandimeve Prioritare» të Këshillit të Ministrave, «Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021» dhe planit të veprimit për zbatim të këtyre rekomandimeve i miratuar me urdhërin nr. 79/2021 ku, veç masave të trajtuara më sipër, shpjegimet janë të detajuara, për masat e zbatuara sipas secilit rekomandim që perfshihen bazuar në të dhënat me tregues për vitin 2021.

Drejtuksi i Prokurorisë ka bërë shpërndarjen dhe njohjen e këtyre akteve të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës. Në vijim në mbledhjet e zhvilluara, Mbledhjet e Prokurorëve janë diskutuar këto Rekomandime dhe janë orientuar prokurorët dhe oficerët në zbatimin e drejtëpërdrejtë dhe më përparësi të tyre gjatë ushtrimit të ndjekjes penale dhe kryerjes së veprimeve hetimore në çështje që janë objekt i Rekomandimeve Prioritare.

Gjatë të gjitha mbledhjeve dhe diskutimeve periodike të realizuara është mbajtur parasysh dhe është respektuar pavarësia e institucionit dhe e prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale dhe në administrimin e materialeve, në kryerjen e hetimeve për çështje të caktuara. Gjithashtu është diskutuar dhe vlerësuar nevoja e nxjerrjes ose jo të urdhërave dhe

udhëzimeve të përgjithshme në lidhje me këto rekomandime dhe është vlerësuar më e drejtë zbatimi i drejtëpërdrejtë nga prokurorët i Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021, si dhe i Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.04, datë 20.07.2021 « Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm », kjo duke pasur parasysh detajimet e mjaftueshme të këtyre akteve nënligjore dhe kohën e nxjerrjes së tyre.

Nga ana tjetër, janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe është kërkuar informacione në lidhje me çështje konkrete objekt i Rekomandimeve prioritare të cilat është vlerësuar se janë komplekse, janë zvarritur apo nuk janë përfunduar me përparësi nga ana e prokurorëve, si dhe nuk janë kryer veprimet hetimore me përparësi nga ana e oficerëve të çështjeve. Në disa raste janë nxjerrë edhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete për të cilat janë vlerësuar të domosdoshme apo edhe ndikuar nga parashikimet e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave.

Masa janë marrë edhe në drejtim të nxitjes së prokurorëve dhe shpejtësisë dhe cilësisë së kryerjes së veprimeve hetimore dhe hetimeve në lidhje me të gjitha procedimet penale, por në veçanti me procedimet penale për çështjet e trajtuara në rekomandimet prioritare. Në fazën e hetimeve u është kërkuar prokurorëve dhe oficerëve të koordinojnë veprimet mes tyre dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese në drejtim të kryerjes në kohë dhe me cilësi të veprimeve hetimore dhe në administrimin e akteve dhe provave për këto çështje. Në disa raste janë ngritur grupe hetimore me prokurorë dhe me oficerë të policisë gjyqësore të prokurorisë, drejtorisë së policisë dhe komisariateve të cilat në përgjithësi kanë dhënë rezultate të kënaqshme. Nga ana tjetër është hasur vështirësi në krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore me institucionet e tjera, me prokuroritë e tjera apo me autoritetet e huaja për shumë arsye, objektive dhe subjektive dhe në këtë drejtim vlerësoj se duhet një punë e madhe për tu bërë me qëllim realizimin e këtij bashkëpunimi dhe marrjen e rezultateve në kohë reale dhe të vlefshme për të dy palët e këtij bashkëpunimi.

Në fazën e gjykimit janë orientuar dhe nxitur prokurorët në aplikimin e instituteve të reja dhe gjykimeve të posaçme dhe në pasjen parasysh të masave të dënimit të përshtatshme në rastin e çështjeve objekt të rekomandimeve. Ka një aplikim në rritje përsa i përket institutit të gjykimit me marrëveshje duke krijuar një praktikë të kënaqshme dhe duke shkurtuar fazën e gjykimit të veprave penale. Nga ana tjetër institutet e gjykimit të drejtëpërdretë dhe gjykimit me urdhër penal kanë gjetur një zbatim shumë të kufizuar dhe në këtë drejtim duhet një nxitje më e madhe, ndoshta deri në ndryshime ligjore. Edhe në drejtim të dhënies së dënimeve përsa i përket llojit dhe masës së dënimeve, si dhe në lidhje me dënimet plotësuese apo kërkesat e tjera është bërë një punë e mirë pamvarësisht faktit të mënyrës së vendimarrjes së gjykatës në këto raste.

Gjithashtu, janë zhvilluar mbledhje periodike me prokurorët dhe me oficerët e policisë gjyqësore janë dheënë orientimet e duhura në lidhje me verifikimin e ecurisë së përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve, plotëshmërisë së hetimeve, në respektimin e afateve hetimore, si dhe në respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal. Vlen për tu theksuar se i është vënë theksi edhe në kthimin e përgjigjeve ndaj subjekteve të procedimeve penale (person nën hetim, i pandehur, viktimë, etj) dhe mbrojtësve të tyre brenda afateve ligjore, pasi në disa raste është konstatuar vonesa apo mosrespektim i afateve apo mospranim i kërkesave të palëve të paarsyetuara nga ana e prokurorëve. Në këto raste, u është tërhequr vëmendja dhe janë nxitur prokurorët në respektimin e afateve ligjore dhe në respektimin e të drejtave të këtyre subjekteve.

-Gjatë vitit 2021, një vëmendje dhe kujdes i veçantë i është kushtuar edhe veprave penale në fushën e krimit të organizuar, si në fushën e narkotikëve (nenet 283/1/2, 283/a/1, 283/a/2, 284,285/a etj).

a) Rezulton se gjatë këtij viti janë hetuar 18 (tetembedhjetë) procedime penale , 13 (trembëdhjetë) procedime penale të regjistruara dhe 5 (pese) procedime penale jane te mbartura. Nga këto procedime 2 (dy) procedime penale janë pushuar kryesisht në rastet e sasisë së vogël dhe kur personat e dyshuar kanë rezultuar përdorues dhe në pak raste për shkaqe të tjera. Janë dërguar për gjykim 8(tetë) procedime penale me 14 (katermbëdhjetë) të pandehur pjesa më e madhe e tyre me masë sigurimi arrest në burg. Ndërsa vijojnë hetimet për 8 (tetë) procedime penale të tjera.

b) Në lidhje me veprën penale «Kultivimi i narkotikëve», të parashikuar nga neni 284 të K.Penal, janë hetuar gjatë këtij viti 12 (dymbëdhjetë) procedime penale. Gjatë këtij viti janë rregjistruar 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale të reja, ndërsa janë mbartur nga një vit më parë 1(një) procedime penale. Nga këto procedime 1 (nje) procedim penale është pushuar. Ndërsa 4(kater) procedime janë pezulluar për mos identifikim të autorëve. 2 (dy) procedime penale me 2 (dy) të pandehur është dërguar për gjykim, për 4 (kater) procedime penale vijojnë hetimet. Në lidhje me këtë veprë konstatohet se në vijimësi pjesa më e madhe e procedimeve pezullohen për mos identifikim të autorëve. Për shkak të terrenit të kultivimit dhe problematikat me pronësinë e tokave dhe kontrollin e territorit është hasur vazhdimisht në vështirësi për identifikimin e autorëve. Nga ana tjetër, administrimi me vonesë i akteve të ekspertimeve kimike ka sjellë edhe zvarritjen e hetimeve për këto procedime dhe mbarjen e një numri të lartë të tyre në vitin pasardhës.

c) Ndersa per vetin 2021 eshte regjistruar 1(nje) procedim penal per veprën penale te parashikuar nga neni 285/a i K.Penal dhe eshte ne hetim.

Në lidhje me rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të veprimeve hetimore të kryera për këto vepra penale janë nxjerrë urdhëra dhe udhëzime për oficerët e policisë gjyqësore dhe janë organizuar takime periodike dhe analiza për veprimet e kryera, duke nxitur rritjen e cilësisë së veprimeve të para hetimore, koordinimin e punës me subjektet e tjera dhe institucionet ligjzbatuese dhe kryerjen e veprimeve dhe hetimeve proaktive si dhe paraqitjen e relacioneve më të plota për çështjet e hetuara apo të përfunduara.

Në lidhje me këto procedime janë kërkuar informacione periodike, si dhe janë nxjerrë udhëzime për çështje konkrete në varësi të rëndësisë së çështjeve, kompleksitetit, kohës së kaluar në hetim, kërkesës së prokurorit të çështjes apo problematikave të evidentuara rast pas rasti. Gjithmonë është synuar drejt verifikimit të përfundimit të çështjeve, respektimin e afateve procedurale të hetimit dhe të paraburgimit, rritjen e efektivitetit dhe plotëshmërisë së hetimeve dhe respektimit të të drejtave dhe garancive të të gjithë subjekteve të procedimit penal.

Në lidhje me hetimin dhe gjykimin e personave të mitur është caktuar një prokuror për të miturit, e cila heton dhe përfaqëson çështjet në gjyq që i përkasin seksionit me të mitur. Gjithashtu në Prokurorinë Kukës është emëruar një koordinatore për viktimat e veprës penale. Prokurorja dhe oficerët e caktuar janë nxitur dhe orientuar në zbatimin me korrektesi dhe rigorozitet të parashikimeve ligjore dhe procedurale të legjisllacionit për të miturit, e në veçanti Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Është synuar në drejtim të respektimit rigoroz të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve. Gjithashtu, është synuar në ndërgjegjësimin e policisë gjyqësore në respektimin e këtyre të drejtave dhe garancive që në fazën e hetimeve të para e në vijim, si dhe gjatë gjykimin të këtyre veprave penale. Vlerësojmë se trajnimi vazhdues i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në lidhje me fushën e miturve do të ndihmojë në rritjen e cilësisë, efektivitetit dhe respektimit më të mirë të të drejtave dhe garancive procedurale të të miturve.

Bashkëpunimi me të gjitha subjektet procedurale dhe trajnimi i tyre me parashikimet ligjore vlerësohet si domosdoshmëri. Gjithashtu, koordinimi më i mirë i punës mes të gjithë faktorëve do të sjellë një hetim më të mirë dhe më të plotë të këtyre veprave penale, duke respektuar gjithmonë detyrimet ligjore dhe të drejtat procedurale të subjekteve të mitur.

Në këtë fushë janë bërë përpjekje dhe është rakorduar edhe me prokuroritë e tjera në lidhje me procedimet penale me të mitur, duke i njohur me parashikimet dhe detyrimet ligjore që pranë çdo prokurorie të krijohet dhe të funksionojë seksioni për të miturit dhe në pamundësi të caktohet një prokuror për të miturit në zbatim të parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit dhe shmangien e marrjen së vendimeve të moskompetencës duke qenë para ndryshimeve ligjore procedurale për hetimin e subjekteve të mitur.

Gjatë këtij viti, është synuar dhe është patur parasysh sigurimi i një bashkëpunimi më të ngushtë dhe më efektiv me të gjitha shërbimet e Policisë Gjyqësore në Prokurori, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës dhe Komisariatet, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, si dhe Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, me policinë gjyqësore të Doganave dhe të Hetimit Tatimor, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, etj, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese. Ku si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi janë kryer hetime në vijimësi duke përdorur edhe metodat speciale të hetimit. Gjithashtu, vijojnë hetimet për një sërë procedimesh penale të referuara nga këto institucione në bashkëpunim mes këtyre shërbimeve të policisë gjyqësore.

Nga ana tjetër vlerësojmë se organizimi i seminareve dhe trajnimeve si të prokurorëve ashtu edhe të oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e veprave penale objekt i rekomandimeve prioritare vlerësohet i domosdoshëm me qëllim kryerjen e hetimeve të shpejta, të plota, efektive dhe cilësore dhe garantimin e të drejtave të këtyre subjekteve.

Një nga problematikat kryesore të konstatuara gjatë vitit 2021, ka qenë mungesa e prokurorëve në organikën dhe strukturën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, e cila ka qenë e cunuar gjatë gjithë vitit. Ka pasur një mungesë prej dy prokurorësh gjatë gjithë periudhës më shumë se 1 vjeçare. Në muajin mars është larguar një prokuror (pezulluar nga KPK) dhe në muajin Qershor një prokuror është shkarkuar nga KLP. Gjithashtu, kjo ka ndikuar edhe në cilësinë e hetimeve, shpejtësinë dhe plotësinë e hetimeve dhe mundësinë e rritjes së efektivitetit, etj. Një problematikë tjetër gjatë vitit 2021, ka qenë edhe shfaqja e pandemisë Covid-19, e cila ka ndikuar drejtëpërdrejtë në punën e Prokurorisë. Gjithashtu, ka ndikuar në reduktimin zhvillimit të mbledhjeve në vijimësi, qoftë të prokurorëve ashtu edhe mbledhjes së përgjithshme të prokurorisë. Kjo ka ndikuar edhe në pamundësinë e zhvillimit të takimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme, qoftë për diskutimin e problematikave të përgjithshme, qoftë edhe për diskutimin dhe analizimin e çështjeve konkrete. Mungesat e prokurorëve, oficerëve dhe nënpunësve për periudha të caktuara për shkak të infektimit të tyre apo të afërmeve të tyre.

-Sa i përket Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 03 datë 29.12.2016 « Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori », për hedhjen e shortit elektronik në periudhën Janar- Dhjetor 2021, janë marrë masa për respektimin e këtij udhëzimi. Është bërë hedhja e shortit elektronik për të gjitha kallëzimet penale. Është treguar kujdes në rastet e marrjes së vendimeve për përjashtim nga shorti të prokurorëve të caktuar, duke u nisur nga ngarkesa e tyre si dhe në rastet me raport mjekësorë. Ndërsa për çështjet e vjetra, të rifilluara, të kthyera nga gjykata dhe kur është bërë zëvendësimi i prokurorit apo heqja dorë është aplikuar shorti manual për shkak të pamundësisë së hedhjes së shortit elektronik. Në rastet e çështjeve me të mitur i janë caktuar direkt prokuores e cila merret me hetimin e çështjeve me të mitur.

-Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 8/2020 datë 19.05.2020 « Për shpenzimet procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm » i ndryshuar me udhëzimin nr. 06/2021 datë 23.07.2021, ku në nenin 36 të ndryshuar të udhëzimit parashikohet raportimi periodikisht i

shpenzimeve procedurale nga zyrat e financës në secilën prokurori, janë kryer 684.000 lekë shpenzime në Prokurorinë Kukës sipas veprave penale dhe zërave përkatës për procedimet të përfunduara.

-Udhëzimi i Përgjithshëm nr.05/2020 datë 13.05.2020 « Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së shërbimit të ekspertizës » për të siguruar konsulta teknike dhe asistencë apo këshillime mbi kërkesat e prokurorëve, për procedime apo çështje penale në fushat ekonomike, financiare, bankare, kontabël, fiskale auditimi të brendshëm publik në fushat inxhinierike – mekanike, autoteknike, qarkullimit dhe/ose sigurisë rrugore, janë kryer shpenzime të ekspertizës në vlerën 3.363.500 lekë (përkthime dhe avokatë). Problematikë për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës ka qenë mospasja e një eksperti mjeko-ligjor dhe për këtë fakt kemi qenë të detyruar të transportojmë të dëmtuarit apo viktimën për në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë apo dhe në morgun pranë spitalit QSUT Tiranë.

II. TREGUESIT E PROCEDIMEVE PENALE TË TRAJTUARA GJATË VITIT 2021


Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për vitin 2021 është ushtruar ndjekje penale dhe janë trajtuar 894 procedime penale, duke përfshirë në këtë shifër procedimet penale të mbartura nga viti 2020 gjithsej 189 procedime penale, të regjistruara në vitin 2021 gjithsej 705 procedime penale.

Numrin më të madh të këtyre procedimeve penale e zënë veprat penale për kalim të paligjshëm të kufirit, ku për këtë vit janë regjistruar 148 procedime penale, veprat penale të vjedhjes së pasurisë ku për këtë vit janë regjistruar 47 procedime penale, veprat penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor 23 procedime, vepra penale e drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt ku për këtë vit janë regjistruar 29 procedime penale, veprat penale e plagosjes së lehtë me dashje, ku për këtë vit janë regjistruar 18 procedime penale, për veprën penale të ndërtimi i paligjshëm ku për këtë vit janë regjistruar 82 procedime penale, për veprën penale të prerjes së paligjshme në pyje, gjithsej 17 procedime penale si dhe për veprën penale “*Dhuna në familje*”, gjithsej 21 procedime penale, për veprën penale “*Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit*”, gjithsej 38 procedime penale etj.


Për vitin 2021 janë regjistruar gjithsej 962 materiale kallëzuese nga të cilat 761 janë referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës dhe Komisariteve Policisë Kukës dhe Has.

164 materiale kallëzuese kanë ardhur me shpallje moskompetence nga prokuroritë e tjera, 12 materiale kallëzuese kanë ardhur nga institucione të ndryshme si : IKTM, Banka, Ujesjellës Kanalizime Sha.Kukës, OSSHE, 23 materiale kallëzuese janë regjistruar në bazë të kallëzimeve të shtetasve dhe 2 procedime penale janë filluar kryesisht.


Materialet e referuara gjatë vitit 2021



Më konkretisht treguesit e çeshtjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2021 krahasuar me treguesit e vitit 2020 paraqiten në grafikët më poshtë:



Gjithashtu në këtë vit është vendosur mosfillimi për 214 kallëzime penale.



❖ **Mbi zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm:**

Të gjitha udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm janë diskutuar në takimet me prokurorët dhe nuk ka pasur probleme në zbatimin e tyre.

❖ **Mbi zbatimin e Rekomandimeve e të Këshillit të Ministrave dhe Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë:**

Në lidhje me hetimet proaktive sikundër e tregojnë edhe të dhënat statistikore për vitin 2021 janë regjistruar vetëm 13 (trembëdhjetë) procedime penale. Për shkak të volumit të madh të procedimeve penale që trajtojnë dhe për shkak të rritjes së përfaqësimeve në gjykatë është e vështirë që prokurorët të angazhohen në hetime proaktive.

Ka rritje të numrit të hetimeve duke përdorur teknikat speciale të hetimit kryesisht përgjime telefonike, autorizime vëzhgimi, përgjime ambjentale etj.

Në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit ka ashpërsim të politikës penale duke kërkuar masat e sigurimit “*arrest në burg*” si dhe llojin e dënimit me burgim për veprat penale të cilat kanë rrezikshmëri të theksuar shoqërore apo shkallë të gjërë përhapje si veprat penale kundër jetës dhe shëndetit (vrasja dhe plagosja e rëndë me dashje), veprat penale në fushën e lëndëve narkotike, për veprën penale të dhunës në familje, veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake në ambjente të hapura për publikun, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasoje vdekjen etj.

Në lidhje me zbatimin e kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë më të mitur të gjitha procedimet penale me të mitur në konflikt me ligjin janë përfunduar në kohë optimale. Nuk ka zgjatje të afateve të hetimit dhe 13 (trembëdhjetë) raste janë aplikuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale.

Përsa i përket përmirësimit të aftësive profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve për shkak të numrit të vogël si të oficerëve të policisë gjyqësore ashtu edhe prokurorëve është e pamundur krijimi e një seksionit të veçantë për procedimet penale me të mitur.

Për veprat penale të dhunës në familje për vitin 2021 janë regjistruar vetëm 30 procedime penale dhe këto procedime penale kanë përfunduar brenda afatit 3 mujor të hetimeve. Për autorët e këtyre veprave penale kërkohet pothuajse në cdo rast masa e sigurimit personal shtërngues “*Arrest ne burg*” dhe për 9 (nëntë) raste është bërë kërkesë për pushim.

Vëmendje i është kushtuar respektimit të të drejtave të viktimës të veprës penale. Në çdo rast viktimat njoftohet për përfundimin e hetimeve, mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Ka angazhim nga prokurorët për t’iu përgjigjur kërkesave të viktimave gjatë fazës së hetimeve paraprake.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2021 nuk ka patur rast të referuar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Nga agjensitë e tjera të zbatimit të ligjit janë referuar gjithsej 2 procedime penale ardhur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

Në zbatim të Reformës në Drejtësi ka patur angazhim maksimal për të kthyer përgjigje institucioneve përkatëse në një kohë rekord lidhur me të dhënat që iu referohen subjekteve të verifikimit me qëllim për të mos sjellë pengesa në përcjelljen e informacionit të kërkuar.

Kemi patur një bashkëpunim shumë të mirë me Prokurorinë e Përgjithshme, Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së akteve dhe kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive. Falë këtij bashkëpunimi të gjitha procedurat e ekstradimit por edhe të ekzekutimit të letërporosive janë bërë duke respektuar afatet e përcaktuara në ligjin procedural penal dhe marrëveshjeve përkatëse të ndërsjellta.

Gjatë vitit 2021 janë përdorur institutet procedurale si urdhëri penal në 58 procedime penale, marrëveshjet e fajësisë për 7 procedime penale.

❖ **Treguesit e punës gjatë hetimeve paraprake, në gjykim, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale, marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.**

Në mënyrë të përmbledhur po paraqesim tendencën e kriminalitetit për vitin 2020 – 2021, paraqitur si më poshtë:

KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ¹	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja ²						1	1	1	1	
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim										
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese										
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë										
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit										
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare										
Neni 80										
Neni 81 Vrasja e foshnjës										
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike										
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/gjakmarrje										
Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	7	1	2	2	2	13	1	1	1	1
Totali	7	1	2	2	2	14	2	2	2	1

KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia										
Totali										

VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia										
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia										
Totali										

VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas										
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.										
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë										
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	3					1				
Neni 97 Mosdhënia ndihmë										
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes										
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	12					6				
Totali	15					7				

KRIME SEKSUALE	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur										
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç						1				
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritura										
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur										
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	2	1	2	2						
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërcënim me përdorimin e armës										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra të turpshme	1									
Totali	3	1	2	2		1				

VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT	2020					2021				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit	1					2				
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese										
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise						1	1	1	1	1
Neni 109/c Zhdukja me forcë										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirisë						1				
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera										
Neni 112 Dhunimi i baneses										
Totali	1					4	1	1	1	1

VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT	2020					2021				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 113 Prostitucioni										
Neni 114 Shfrytëzimi i prostitucionit										
Neni 115 Mbajtja e lokaleve për prostitucion										
Neni 117 Pornografia										
Neni 118 Dhunimi i varreve										
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Ndërhyrje të padrejta në jetën private	1					2				
Neni 121/a Përndjekja										
Neni 122 Përhapja e sekreteve vetjake										
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës										
Totali	1					1				

VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES	2020					2021				
Gjithsej ka patur në hetim për këto grup veprash penale 408 **procedime penale** me 73 persona nën hetim e 260 të pandehur, nga të cilët 67 persona të arrestuar.

Janë pushuar gjithsej 74 procedime penale, nga të cilat për mungese fakti 19 procedime penale, janë pushuar 53 procedime për shkaqe të tjera si dhe 2 procedime penale për mungesë prove.

Janë **pezulluar** hetimet për mosnjohje të autorit për 12 procedime penale, nga të cilat 4 procedime penale për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, parashikuar nga neni 284/1 të K.Penal, 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 277 të K.Penal si dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 238, 275, 290/1, 290/3, 293/b/1 e 298/1 të K.Penal.

Është vendosur **shpallja e moskompetencës** për 7 procedime penale me 6 persona në hetim.

Janë **dërguar gjyqit** 232 **procedime penale me 259 të pandehur**, nga të cilët 41 prej tyre kanë qenë me masën e sigurimit “*Arrest në burg*”.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim :

132 procedime penale për veprën penale kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror me 138 të pandehur, 25 procedime penale për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt me 25 të pandehur, nga të cilët 4 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 16 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 298/1/2/3 të K.Penal me 16 të pandehur nga të cilët 14 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 6 procedime penale për veprën penale të “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*” me 6 të pandehur, nga të cilët 2 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 6 procedime për veprën penale “*Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik*”, parashikuar nga neni 242 të K.Penal me 6 të pandehur, nga të cilët 1 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”, 3 procedime penale për veprën penale të “*Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik*” me 6 të pandehur, 3 prej tyre të arresuar, 2 procedime penale me 2 të pandehur, me 2 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 284/1/2 të K.Penal, 6 procedime penale me nga 6 të pandehur për veprat penale të parashikuara nga nenet 272 e 275 të K.Penal, 4 procedime penale me 5 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 277, 4 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1 me 4 të pandehur, nga të cilët 3 të arrestuar, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 të K.Penal, 1 procedim penal me 8 të pandehur, 2 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 274 të K.Penal me 2 të pandehur, 2 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 273 të K.Penal me 2 të pandehur, 2 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a-1 me 4 të pandehur, ndër të cilët 4 të arrestuar si dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 235, 238, 244/1, 248, 279/2,

283/2 e 283/a/2 të K.Penal me 7 të pandehur, nga të cilët 2 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Gjatë vitit 2021 janë përfunduar gjithsej për këto grup veprash penale 325 procedime penale, me 259 të pandehur, nga të cilët 41 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 83 procedime penale.

Nga treguesit konstatohet se kemi pothuaj të njëjtin numër sa i përket veprës penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror 150 (148) si dhe të asaj të parashikuar nga neni 277 me nga 10(10).

Gjatë këtij viti ka patur një rritje për veprat penale, kultivimit të bimëve narkotike 9 (11), të veprës penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt 22(29), të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve 9 (11), të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor 18 (23), të shpërdorimit të detyrës 9 (17) si dhe të mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë se rendit publik 7 (13) etj..

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Për këtë grup veprash penale është mbartur nga viti 2020 një procedim penal.

Për vitin 2021 janë regjistruar 11 procedime penale me 5 të pandehur nga të cilët 6 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

VEPRAT PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA

Për këtë grup veprash penale nuk ka patur procedime penale të mbartura nga viti 2020.

Edhe për vitin 2021 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë grup veprash penale.

TREGUESIT NË GJYKIM

Treguesit e përgjithshëm të çështjeve penale të gjykuara

Gjithsej për vitin 2021 kanë qenë në gjykim gjithsej 403 çështje penale me 448 të pandehur, ndër ta, 77 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.


Gjatë vitit 2021 janë gjykuar 303 çështje penale me 330 të pandehur dhe 42 të arrestuar.

Nga këto, janë gjykuar me gjykim të zakonshëm 45 çështje penale, me gjykim të shkurtuar 251 çështje penale, me gjykim në mungesë 5 çështje penale si dhe me gjykim të drejtëpërdrejtë 5 çështje penale.

Për vitin 2021 janë bërë 58 kërkesa për miratim të urdhërit penal, ku nga gjykata janë miratuar 51 urdhëra penal.

Janë bërë 8 kërkesa për miratim marrëveshje dhe nga gjykata janë miratuar 7 marrëveshje si dhe është refuzuar 1 marrëveshje.

Jane bërë 204 kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq me 208 të pandehur, ku është miratuar kërkesa për dërgim në gjyq 159 procedime penale, ndërsa 45 kërkesa janë ende në fazën e seancës paraprake.



Për vitin 2022 kanë mbetur në gjykim 100 *çështje penale me 118 të pandehur, ndër të cilët 35 të arrestuar.*

❖ **Llojet dhe dhe masa e dënimit të kërkuara nga prokurorët:**

Për 126 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë, për 18 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 33 të pandehur dënim me burgim mesatar si dhe është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë për 162 të pandehur.

❖ **Vendimet e Gjykatës për llojet dhe masat e dënimit:**

Për 126 të pandehur është vendosur dënimi me gjobë, për 16 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 33 të pandehur me burgim mesatar, për 158 të pandehur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, për 1 çështje është vendosur pushimi i akuzës për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal, për 6 çështje është vendosur pafajësi, këto për veprën penale të parashikuar nga neni 170/ç-1 të K.Penal, vendime të cilat janë apeluar në Prokurorinë e Apelit Shkodër.

❖ **Të dhënat për vendimet e pafajësisë, ndryshimet e cilësimit juridik të veprës penale në gjykatë apo gjatë hetimeve paraprake si dhe kërkesat për pushim me persona të arrestuar:**

Për vitin 2021 nga gjykata është dhënë pafajsi në 6 raste.

Gjykata ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik në 6 raste.

Në të 6 rastet kur gjykata ka vendosur pafajësi është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila vazhdon ti ketë në shqyrtim akoma.

Në raport me numrin e procedimeve penale të gjykuara, pafajësitë dhe ndryshimi i cilësimit juridik të faktit penal janë në nivel të paperfillshëm.

Këtij argumenti i shërben fakti se me ndryshimet Ligjore në K.Pr.Penale roli i gjykatës në kontrollin e hetimit ka evidentuar efikasitet në ngritjen e akuzave nga prokurori dhe administrim të drejtë, të saktë e ligjor të provave në hetim për të vërtetuar akuzat.

❖ Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, mosha, arsimi, punesimi etj.




Për vitin 2021 janë dënuar 323 të pandehur, nga këto 306 janë meshkuj dhe 17 të pandehura femra dhe 9 të pandehur shtetas të huaj.

Janë dënuar 250 persona me arsim 8-9 vjeçarë, 69 persona me arsim të mesëm dhe 4 persona me arsim të lartë.

Janë dënuar 3 persona me gjendje shoqerore nëpunës të thjeshtë, , 1 person me gjendje shoqerore nëpunës i mesëm, 1 person me gjendje shoqerore nëpunës i lartë, 40 persona në sektor privat si dhe 278 persona të papunë.

Janë dënuar 110 persona me banim në qytet dhe 213 persona me banim në njësitë administrative të Bashkive Kukës e Has.

Janë dënuar 308 persona me gjendje gjyqësore të padënuar, 12 persona me gjendje gjyqësore përsëritës të veprave penale të ndryshme, dhe 3 persona përsëritës të të njëjtës vepër penale.



❖ **Të dhënat për procedimet penale për të miturit në konflikt me ligjin:**

Për vitin 2020 janë regjistruar 17 procedime, me 20 persona të mitur në konflikt me ligjin, për veprat penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 134 të K.Penal, drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i K.Penal, kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror parashikuar nga neni 297 i K.Penal si dhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 101/1, 161 e 189/1 të K.Penal.

Për 9 referime të ardhura nga Policia është vendosur mos fillimi i procedimit penal., për 2 procedime penale, me 2 persona të mitur nën hetim është vendosur pushimi i procedimit penal për shkak se janë aplikuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe 3 procedime penale me 3 të pandehur(nga të cilët 1 me masë sigurimi “*Arrest në shtëpi*” janë dërguar në gjykim, ku për 2 është dënuar me dënim alternativ punë në interes publik.

Më poshtë po i trajtojmë më hollësisht treguesit e çështjeve penale në gjykim.

VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT

Nga viti 2020 janë *mbartur* në gjykim 37 çështje penale me 21 të pandehur, nga të cilët 7 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Gjatë vitit 2021 janë *dërguar për gjykim* 45 çështje penale me 50 të pandehur, nga të cilët 19 përsone të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej nga këto grup veprash penale 26 procedime penale me 30 të pandehur, 8 të arrestuar.

Për vitin 2022 kanë *mbetur në gjykim* 19 çështje penale me 20 të pandehur, 11 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga Prokurorët :

Dënim me burgim në minimum (neni 130/a/1 i K.Penal), për 5 të pandehur, dënim me burgim mesatar (neni 103/1 i K.Penal), për 2 të pandehur dënim me burgim me kusht (nenet 84(me 2 të pandehur,, 89(me 9 të pandheur e 130/a/1 të K.Penal me 7 të pandehur).

Edhe nga ana e Gjykatës janë dhënë dënime sipas kërksesës së bërë nga ana e Prokurorit për 5 të pandehur dënim me burgim në minimum (neni 130/a/1 të K.Penal), dënim me burgim mesatar (neni 103/1 i K.Penal), për 2 të pandehur dënim me burgim me kusht (nenet 84(me 2 të pandehur,, 89(me 9 të pandheur e 130/a/1 të K.Penal me 7 të pandehur).

Për vitin 2021 nuk kemi patur për këtë grup veprash asnjë dhënie pafajsie.

VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË

Janë mbartur në gjykim nga viti 2020 gjithësjet 77 çështje penale me 22 të pandehur nga të cilët 4 të arrestuar.

Për vitin 2021 janë dërguar gjithsej në gjykim 111 çështje penale me 120 të pandehur nga të cilët 11 të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej 91 çështje penale, me 103 të pandehur, nga të cilët 8 të arrestuar.

Për vitin 2022 kanë mbetur në gjykim 25 çështje penale me 25 të pandehur me 5 të arrestuar.

Në konkluzionet përfundimtare nga Prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi :

Për 6 të pandehur dënim me burgim në minimum(nenet 180/1 e 189/2 i K.Penal), për 2 të pandehur dënim me burgim në minimum(nenet 134/1 e 151 të K.Penal), të pandehur dënim mesatar(nenet 134/2(1 çështje), 141/a/1(2 çështje) e 143/1 të K.Penal(1 çështje)

Për 91 të pandehur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë(58 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1, 7 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/2 të K.Penal dhe për 1 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/3 të K.Penal, 3 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 e 137/2 të K.Penal), 6 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 170/ç/1 të K.Penal, 3 çështje me gjithsej 3 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 193 i K.Penal, nga 2 çështje me gjithsej 8 të pandehur për veprat penale të parashikuar nga nenet 134/1, 170/a/1, 179/a e 189 të K.Penal) si dhe nga 1 të pandehur për veprat penale të parashikuara nga nenet 172/1, 187/1, 190/1, 199, 199/a/3 e 200 të K.Penal.

Për këtë grup veprash penale Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur në përgjithësi në përputhje me kërkesën e Prokurorit me përjashtim të një rasti kur Prokurori ka kërkuar dënim me burgim mesatar dhe Gjykata ka vendosur dënimim me burgim me kusht.

VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT

Nga viti 2020 ka patur 7 çështje të mbartura në gjykim për këto grup veprash penale(për veprën penale të parashikuar nga neni 205 të K.Penal).

Për vitin 2021 janë dërguar për gjykim 3 çështje penale me 3 të pandehur.

Është kërkuar nga ana e Prokurorit dënim me kusht për 1 çështje me 1 të pandehur si dhe dënim me gjobë për 1 çështje(neni 205 i K.Penal), si dhe 1 çështje për veprën penal të parashikuar nga neni 206 i K.Penal ku sipas akt ekspertimit psikiatrik, personi i akuzuar(grua) është perjashtuar nga përgjegjësia penale si i papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së saj mendore, kërkesë e cila është miratuar edhe nga ana e Gjykatës.

Për vitin 2022 nuk kemi të mbartur në gjykim asnjë çështje penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT

Nga viti 2020 kanë qenë të mbartura 67 çështje penale me 54 të pandehur, nga të cilët 8 të arrestuar.

Gjatë vitit 2021 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 232 çështje penale me 259 të pandehur, me 41 të arrestuar.

Janë gjykuar gjithsej 178 çështje penale me 189 të pandehur, nga të cilët 22 të arrestuar.

Për vitin 2022 kanë mbetur në gjykim për këto grup veprash penale 56 çështje penale me 73 të pandehur, nga të cilët 19 me masë sigurimi “*Arrest në burg*”.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga prokurorët këto lloje dhe masa dënimi :

Për 122 të pandehur dënim me gjobë, për 4 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 20 të pandehur dënim me burgim mesatar dhe për 50 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Gjykata ka vendosur për 122 të pandehur dënim me gjobë, për 5 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 19 të pandehur dënim me burgim mesatar dhe për 50 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Për 1 të pandehur është vendosur pushimi i çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a-2 të K.Penal.

Për rastet kur Gjykata ka vendosur pafajësisë, nga prokurori i çështjes është apeluar vendimi në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Dënimi me gjobë është vendosur për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror në 118 çështje si dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 242 të K.Penal në 3 çështje penale.

VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Nga viti 2021 kemi patur 1 çështje penale të mbartur për veprën penale të parshikuar nga neni 305 të K.Penal.

Gjatë vitit 2021 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 11 çështje penale me 5 të pandehur, me 6 të arrestuar.

Theksojmë se për këtë grup veprash penale, 6 procedime penale janë për veprën penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga neni 323 të K.Penal, 2 për veprën penale të parshikuar nga neni 301 të K.Penal dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 305, 306/1 e 321/2 të K.Penal.

TREGUESIT E MASAVE TË SIGURIMIT

Gjatë vitit 2021 janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 151 të pandehur.

Janë ndaluar me urdhër të Prokurorit 11 të pandehur.

Është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “*Arrest në burg*” në mungesë për 9 të pandehur.

Rezulton se gjykata ka vleftësuar si të ligjshme arrestet në flagrancë si dhe urdhërat e ndalimit të bëra nga ana e Prokurorisë.

Është kërkuar masa e sigurimit “*Arrest në burg*” për 86 persona në hetim, për 9 të pandehur masa e sigurimit “*Arrest në burg*”, në mungesë, për 1 person nën hetim masa e sigurimit “*Arrest në burg*” me afat, për 21 të pandehur masa e sigurimit “*Arrest në shtëpi*”, për 39 të pandehur “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”.

Gjykata ka vendosur për 82 të pandehur masën e sigurimit “*Arrest në burg*”, për 8 të pandehur “*Arrest në burg*” në mungesë, për 19 të pandehur “*Arrest në shtëpi*”, për 1 të pandehur “*Arrest në burg*” me afat, për 49 të pandehur “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”.

Nga treguesit statistikor konstatojmë se janë mbështetur nga gjykata në pjesën më të madhe kërkesat e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar në ato raste, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, shtrirjen e veprës penale në vend.

Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar për veprat penale kundër jetës së personit, plagosjes së rëndë me dashje, tek vepra penale e dhunës në familje, tek veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë, për krimet në fushën e doganave, si vepra penale e kontrabandës, si dhe tek veprat penale kundër autoritetit të shtetit, falsifikimi i dokumentave, prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kultivimi i bimëve narkotike, parashikuar nga nenet 283 e 284 të K.Penal, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, parashikuar nga nenet 290/1/2/3 të K.Penal tek veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, tek veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kur drejtuesi i mjetit ka qenë recidivist në rastet kur ka qenë i pa pajisur me leje drejtimi apo kur drejtuesi i mjetit ka qenë në gjendje të dehur etj.

TREGUESIT E KËRKESAVE PËR PUSHIM TË ÇESHTJES

Kërkesat e Prokurorit për pushim të çeshtjes janë pranuar nga gjykata në 100% të rasteve. Ky tregues konfirmon saktësinë e vlerësimit të provave nga ana e prokurorit në hetim. Numri më i madh i këtyre kërkesave është për çeshtje që pushohen në aplikim të nenit 66 të Kodit Penal. Një numër i madh çeshtjesh(303) që ka përbërë një problematikë në vetevete për Prokurorinë Kukës për vitin 2019.

Nisur nga numri i senacave gjyqësore ku proceduralisht prokurori ka të detyrueshme pjesmarrjen, vlerësohet se një inisiativë për rishikimin e nenit 329/b, paragrafi 2, i K.Pr.Penale lidhur me praninë e prokurorit në seancën gjyqësore për pushimin e çeshtjes në rastet e aplikimit të nenit 66 të Kodit Penal, do të rriste efikasitetin e prokurorit në hetim. Kërkesat për pushim të çeshtjes penale në aplikim të nenit 66 të Kodit Penal, kërkojnë kohë fizike të detyrueshme për pjesmarrje në senacat gjyqësore të konsiderueshme dhe objektivisht pa asnjë lloj produkti ligjor. Kjo kohë do të ishte shumë me produktive në funksion të hetimit penal.

Gjithsesi ky konstatim e sugjerim duhet vlerësuar duke konsideruar saktë raportin specifikisht të këtyre lloj kërkesash procedurale në çdo Zyrë Prokurorie .

Pjesmarrja e Prokurorëve në seancat gjyqësore ka rezultuar korrekte, pavarësisht ngarkesës që ka ekzistuar.

TREGUESIT E ZGJATJES SË AFATEVE TË HETIMEVE PARAPRAKE

Afatet e hetimit janë zgjatur si më poshtë vijojnë:

- ❖ deri në 3 muaj për 8 procedime penale me 8 të pandehur, 4 prej tyre ka qenë të arrestuar.
- ❖ mbi 3 muaj deri në 6 muaj janë zgjatur afatet për 2 procedime penale me 2 të pandehur dhe 1 të arrestuar.
- ❖ mbi 6-9 muaj janë zgjatur hetimet për 2 procedime penale me 6 të pandehur dhe 1 të arrestuar.
- ❖ mbi 9 muaj nuk kemi patur asnjë zgjatje hetim.
- ❖ Po kështu edhe mbi 1 vit nuk kemi patur asnjë zgjatje hetimi lidhur me procedimet penale të regjistruara nga ana e Prokurorisë Kukës..

Siç shihet nga treguesit statistikor ka patur angazhim për të përfunduar hetimet paraprake në një kohë sa më shpejtë të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi zgjidhjes së duhur të procedimeve penale brenda afatit ligjor, duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke garantuar të drejtat procedurale të subjekteve të procedimit penal si dhe dhënien e drejtësisë në kohë.

TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË

Gjatë vitit 2021 janë paraqitur në gjykatë 27(njzet e shtatë) **kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit** të personave të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të kërkuar nga Autoritetet e Shteteve të Tjera.

Gjykata ka vendosur lejimin e ekstradimit për 24 persona dhe për 3 ekstradime jemi në pritje të vendimeve të formës së prerë nga gjykatat, pasi janë ankuar subjektet.

Është ekzekutuar kërkesa për ekstradim nga jashtë shtetit për 7 të dënuar.

Janë ekzekutuar 25 **letërporosi nga jashtë shtetit**, kryesisht nga autoritetet e drejtësisë kosovare, që kanë patur të bëjnë me njoftimin e dëshmitarëve apo të të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, etj.

Janë dërguar për jashtë shtetit 14 letërporosi.

Për vitin 2021 kemi patur 2 raste për njohje të vendimit penal të huaj.

Janë shpallur në kërkim ndërkombëtar për vitin 2021, 2 shtetas me vendim të formës së prerë, si dhe 10 persona në hetim me masë sigurimi “*Arrest në burg*” në mungesë.

TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Nga viti 2020 kanë qenë të mbartura vendime të paekzekutuara për 16 të dënuar me burgim, për 245 të dënuar me gjobë dhe 97 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2021 janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 38 të dënuar me burgim, për 73 të dënuar me gjobë, për 164 të dënuar me kusht dhe për 8 të dënuar duke aplikuar nenin 63 të K.Penal (3 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal, si dhe nga 1 procedim penal për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 187/1, 190/1, 272 e 273 të K. Penal).

Gjatë vitit 2021 rezulton të jenë ekzekutuar tërësisht vendimet penale për 35 të dënuar me burgim, 29 të dënuar me gjobë, për 59 të dënuar me kusht si dhe për 4 të dënuar me kusht duke aplikuar nenin 63 të K.Penal.

Gjatë vitit 2021 është bërë kërkesë në gjykatë për revokim të aplikimit të nenit 59 të K.Penal për 6 të dënuar me dënime alternative, kërkesa të cilat janë ende në fazën e gjyqimit.

Nuk janë ekzekutuar 5 kërkesa caktim mase sigurimi “*Arrest në burg*” në mungesë.

TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT

Gjate vitit 2021 nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme si në hetimin e procedimeve penale ashtu edhe në përfaqësime në gjykatë duke patur parasysh se me ndryshimet e ligjit procedural penal në vitin 2017 tashmë përfaqësohen në gjykim edhe kërkesat për pushimin e procedimeve penale të regjistruara për krime.

Më konkretisht po japim ngarkesën e punës për secilin prokuror si dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

❖ Prokurori **Xhevahir LITA** :

Me funksionin si Drejtues i Prokurorisë gjatë periudhës Korrik 2021 e në vazhdim, ka hetuar gjithsej 175 procedime penale. Nga këto janë përfunduar 95 procedime penale dhe 80 janë në hetim.

-Janë dërguar për gjykim 44 procedime penale, janë pezulluar 8 procedime penale, janë pushuar 42 procedime penale, transferuar 1 procedim penal.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 30 kallëzime penale.

Po kështu gjatë këtij viti janë rifilluar dhe me pas është vendosur pushimi për 22 procedime penale të regjistruara në vitet e kaluara për të cilat ishin pezulluar hetimet për mos zbulim të autorit të veprës penale. Pushimi i tyre është bërë për efekt parashkrimi të ndjekjes penale (parashkrime).

-Nga Prokurori Xhevahir LITA është përfaqësuar akuza në gjykatë për 69 çështje penale me 69 të pandehur, (22 të arrestuar, 2 me A.SH, 8 me detyrim për paraqitje dhe 37 të pandehur në gjendje të lirë).

-Nga Prokurori janë dhënë masa dënimi për 20 të pandehur dënime me burgim, 25 të pandehur denim me burg (vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim), për 24 të pandehur denim me gjobë.

Një volum të madh pune ka përballuar prokurori në ekzekutimin e vendimeve penale ku gjatë vitit 2021 janë nxjerrë urdhëra ekzekutimi si dhë në rastet kur i dënuari e ka kryer dënimin në rastet e dënimeve me kusht është nxjerrë vendim për kryerjen e dënimit për 69 raste.

Nga ana e këtij prokurori është ushtruar apelim për masat e sigurimit për 4 (katër) persona përkatësisht për veprat penale 298/2, dhe 290/2, kur gjykata ka vendosur masa më të buta sigurimi se ato të kërkuara nga ana e Prokurori.

Nga ana e këtij prokurori është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 4 raste.

Po kështu nga ana e këtij Prokurori është përballuar një ngarkesë e madhe edhe sa i përket të dhënave statistikore për vitin 2021.

Ekstradime :

Po kështu nga ana e kësaj Prokurore është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 7 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkomëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës .

Letërporosi :

Prokurori ka dërguar 25 Letër-Porosi nga jashtë shtetit.

❖ **Prokurore Fahrije VATA :**

Ka hetuar gjithsej 280 procedime penale, nga të cilat ka përfunduar 224 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 56 procedime penale.

-Janë dërguar për gjykim 122 procedime penale, janë pezulluar 37 procedime penale si dhe janë pushuar 57 procedime penale janë transferuar 8 procedime penale.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 74 kallëzime penale.

Janë rifilluar 22 procedime penale të viteve të kaluara dhe më pas është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale (parashkrime).

-Nga ana e prokurores Fahrije Vata është përfaqësuar akuza në gjykatë për 141 çështje penale me 150 të pandehur (11 të arrestuar, 3 me A.SH, 5 të pandehur me detyrim për paraqitje, 1 me garanci pasurore dhe 130 të pandehur në gjendje të lirë).

-Nga Prokurorja janë dhënë 65 dënime me gjobë, 24 dënime me burg dhe 51 dënime alternative (burg me kusht), 1 kthyer nga gjykata për hetim.

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 4 raste përsa u perket masave të sigurimit kur gjykata ka vendosur masa më të buta sigurimi se ato të kërkuara nga ana e Prokurores. Vendimet e ankimuar janë lenë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 4 raste.

Në 3 raste nga ana e Gjykatës është dhënë pafajsi për 9 të pandehur (përkatësisht për veprat penale parashikuar nga neni 170/ç, 291, 130/ a/1. Në të 4 rastet është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila vazhdon ti ketë në shqyrtim akoma.

Ekstradime :

Po kështu nga ana e kësaj Prokurore është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 4 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkomëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës .

❖ **Prokurore Enkeleda HOXHA :**

Ka hetuar gjithsej 317 procedime penale, nga të cilat ka përfunduar 255 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 62 procedime penale.

-Janë dërguar për gjykim 149 procedime penale, janë pezulluar 27 procedime penale si dhe janë pushuar 75 procedime penale janë transferuar 4 procedime penale.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 92 kallëzime penale.

Janë rifilluar 18 procedime penale të viteve të kaluara dhe më pas është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale (parashkrime).

-Nga ana e prokurores Enkeleda Hoxha është përfaqësuar akuza në gjykatë për 129 çështje penale me 134 të pandehur (21 të arrestuar, 9 me A.SH, 10 të pandehur me detyrim për paraqitje dhe 94 të pandehur në gjendje të lirë).

-Nga Prokurorja janë dhënë 54 dënime me gjobë, 19 dënime me burg dhe 61 dënime alternative (burg me kusht).

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim përse u perket masave të sigurimit për në 10 (dhjetë) persona nën hetim, kur gjykata ka vendosur masa më të buta sigurimi se ato të kërkuara nga ana e Prokurores.

Nga ana e kësaj prokurore është ushtruar apelim për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës në 4 raste. Në 4 rastet është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila vazhdon ti ketë në shqyrtim akoma.

Ekstradime :

Po kështu nga ana e kësaj Prokurore është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 10 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

❖ Prokurori Edmond KARIQI

Ka përfunduar gjithsej 107 procedime penale deri në Qershor të vitit 2021.

-Janë dërguar për gjykim 77 procedime penale, janë pezulluar 27 procedime penale, është pushuar 1 procedim penal si dhe janë transferuar 2 procedime penale.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 15 kallëzime penale.

-Nga ana e prokurorit Edmond Kariqi është përfaqësuar akuza në gjykatë për 54 çështje penale me 54 të pandehur (10 të arrestuar, 1 me A.SH, 4 të pandehur me detyrim për paraqitje dhe 39 të pandehur në gjendje të lirë).

-Nga Prokurori është kërkuar për 15 të pandehur dënimi me gjobë, 14 dënime me burgim dhe 25 dënime alternative (burg me kusht).

Nga ana e prokurorit është ushtruar apelim në Gjykatën e Apelit Shkodër për vendimet e dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë Kukës, për 4 raste. Në 2 raste është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, në një rast është bërë ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe një rast vazhdon të jetë në shqyrtim akoma.

Ekstradime :

Po kështu nga ana e prokurorit është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 5 raste në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar, të cilat janë miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës .

❖ Prokurori **Rita GJATI**

Ka përfunduar gjithsej 6 procedime penale deri në Mars të vitit 2021.


-Janë dërguar për gjykim 4 procedime penale, është pezulluar 1 procedim penal, është pushuar 1 procedim penal.

-Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 3 kallëzime penale.

Ekstradime :

Po kështu nga ana e kësaj Prokurore është bërë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës për 1 rast në lidhje me ekstradimin e personave të shpallur në kërkim ndërkomëtar, i cili është miratuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës .

NGARKESA E PROKURORËVE



Moskompetencë	1	8	4	2		15
Pezulluar	8	37	27	27	1	100
Gjykim	44	122	149	77	4	396
Pushuar	42	57	75	1	1	176
Perfunduar	95	224	255	107	6	687

TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Në mënyrë të përmblodhur, paraqesim ngarkesën e punës për oficerët e policisë gjyqësore.

Oficeri i Policisë Gjyqësore **Vladimir Shehu** për vitin 2021 ka hetuar 157 procedime penale, ka përfunduar 123 procedime penale dhe kanë mbetur në hetim 34 procedime penale.

Ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 23 procedime penale, për pushimin e hetimeve 37 procedime penale, për moskopesencë 6 procedime dhe referuar për gjykim 57 procedime penale. Ka mbartur për vitin në vazhdim 12 procedime penale. Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të akteve proceduriale të prodhuara nga ky OPGJ dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.


Oficeri ka ekzekutuar 25 Leter-Porosi nga jashtë shtetit.

Oficeri i Policisë Gjiqësore **Klevis Çifliku** për periudhën Janar – Prill 2021 (transferuar).

Gjatë kësaj periudhë ka përfunduar 22 procedime penale. Ka sugjeruar për pushimin e hetimeve për 7 procedime penale, referuar për gjykim 14 procedime penale dhe ka referuar për pezullim 1 procedim penal.

Oficeri i Policisë Gjiqësore **Besnik Muslija** për periudhën Korrik – Dhjetor 2021 (është komanduar).

Gjatë kësaj periudhë ka përfunduar 16 procedime penale. Ka sugjeruar për pushimin e hetimeve për 1 procedim penal, referuar për gjykim 14 procedime penale dhe ka referuar për transferim 1 procedim penal.



TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJIQËSORE TE SEKSIONEVE TË DVP KUKËS

Në 99% të referimeve të veprave penale nga ana e OPGj të Seksioneve që ushtrojnë veprimtarinë në Drejtorinë Vendore të Policisë dhe dy Komisariateve të Policisë Kukës e Has, bashkrendimi me Prokurorin e Gatshem ka qenë tepër efikas.

Të gjitha procedimet penale të referuara janë hetuar nga Oficerët e kësaj strukture policore. Vlen të theksohet se niveli profesional në hartimin e akteve procedurale, dokumentimin e fakteve penale e administrimin e provave në hetim është jashtë pritshmërisë së Organit Procedues.

Gjithashtu afati i hetimit të çështjeve i përcaktuar nga Prokurori, në menyrë permanente është shkelur në hetim dhe jo në çdo rast për arsye objektive. Mungesa e qëndrueshmërisë organike, transferimet e shpeshta, ndryshimet e emertesës administrative brenda strukturës policore, kanë dhënë efekte negative në hetim.

Problematikë kryesore ka rezultuar, mungesa e theksuar e profesioanlizmit të OPGJ të Komisarariatit të Policisë Kukës.

Është evidentuar se sistemi i kontrollit të punës së OPGJ nga ana e drejtuesve të strukturës së Komisarariatit Policisë ka munguar tërësisht.

Ky konstatim nuk vlen për punën e OPGJ të Seksioneve të Drejtorisë së Policisë, e cila ka reflektuar profesionalizëm, përgjegjshmëri e nivel kontrolli në detaje nga ana e Drejtuesve të saj. U ndalëm në këtë trajtim për faktin se hetimi procedural penal përballohet nga këta oficerë. Dështimi e sukcesi i prokurorit në hetim e gjykim është rezultat i punës së tyre. Për shkak të ngarkesës, Prokurorët jo në çdo rast kanë qenë objektivisht të mundur për të kontrolluar çdo veprim hetimor.

Në këtë kontekst përgjegjshmëria, profesioanlizmi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të hetimit procedural është determinant për ushtrimin efektiv të ndjekjes penale.

Bashkëpunimi me Strukturën Policore të DVP Kukës ka qenë në nivel maksimal dhe në parametra shumë objektiv.

Nga ana e Prokurorëve i është dhënë hapësira e nevojshme brenda kuadrit ligjor çdo inisiative hetimore të OPGJ të strukturës policore.

Janë pranuar kërkesat e paraqitura për hetimin proaktiv në 99% të rasteve. Por mbetet shumë për të bërë lidhur me respektimin e afateve të hetimit penal nga ana e Policisë Gjyqësore të kësaj strukture policore.

Marrdhëniet e Prokurorisë me organet e qeverisjes vendore në rang Qarku së bashku me dy Bashkitë, janë zhvilluar në respektim të kuadrit ligjor e fushës së veprimtarisë së çdo institucioni, me qëllim nxitjen e rritjes së besimit të publikut tek organet e Drejtësisë, duke ngritur në nivel më të lartë bashkëpunimin ndërinstitucional.

Ky bashkëpunim, në respektim të transparencës e pavarësisë së Institucionit ka qenë e do të jetë në vijim indikator i rëndësishëm i rritjes së besimit të publikut tek Institucioni.

Në përballimin e volumit të punës në Prokurorinë Kukës, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e prokurorisë.

Rezulton së gjatë vitit 2021 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS.

Në lidhje me administrimin e prokurorisë gjatë vitit 2021, ka patur një administrim të drejtë për sa i përket zbatimit të buxhetit dhe kapaciteteve infrastrukturore të saj.

Fondet e akorduara nga Prokuroria e Përgjithshme janë menaxhuar në mënyrë efektive sipas parashikimit buxhetor.

Janë krijuar marrëdhënie të besueshme me mediat dhe publikun duke dhënë informacion rreth përhapjes dhe goditjes së kriminalitetit për grup veprat penale që janë në rritje në vendin ku ushtron kompetencën territoriale kjo prokurori.

Menaxhimi i brendshëm i Prokurorisë ka qenë efikas. Ka patur rregullsi në mbajtjen e regjistrave sipas praktikës së normuar të kësaj prokurorie. Po ashtu, ka patur korrektësi në ndjekjen e disiplinës dhe etikës në punë nga punonjësit.


Një detyrë për tu realizuar mbetet rritja e besimit tek publiku, pasi të gjithë indikatorët flasin për një nivel jo të kënaqshëm që kanë qytetarët në drejtësinë penale, ku bën pjesë edhe prokuroria. Për këtë, synojmë që jo vetëm shpejtësia dhe cilësia e hetimit, por edhe transparenca ndaj publikut do të ndikojë për të sjellë një rritje të besimit e për rrjedhojë edhe të bashkëpunimit me ne. Shtimi i informacioneve dhe kthimi i përgjigjeve në kohë drejtë personave që kërkojnë informacion nga prokuroria brenda afatit të arsyeshëm dhe me të dhënat edukative do të shtojë transparençën e këtij institucioni. Çdo prokuror duhet të shfaqë dhe të dëshmojë detyrimin ndaj qytetarëve që me profesionin e tij të japë drejtësi penale të pavarur dhe të pandikuar nga faktorët korruptive, politik, etj.

Angazhohemi në rritjen e komunikimit me mediat lokale e qendrore në tërësi duke respektuar sekretin hetimor, si dhe duke mbrojtuar të dhënat personale të informojmë periodikisht në lidhje me punën e prokurorisë, si dhe me rezultatet dhe arritjet dhe problematikat që dalin në vijimësi në punën tonë.

Informimi i medias dhe i publikut në tërësi, për punën e prokurorisë, si dhe në lidhje me shqetësimet dhe për çështjet sensitive që janë objekt i punës së prokurorisë vlerësojmë se do të ketë një ndikim pozitiv në rritjen e besimit dhe në përmirësimin e imazhit të Prokurorisë.

Për vitin 2021 mbetet prioritet thelbësor përfundimi në kohë të shpejtë i procedimeve penale të mbartura, rritja e shkallës së efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e doganave, në fushën e lëndëve narkotike e trafiqeve të paligjshme, krimit kufitar, në fushën e krimit ekonomik, rritja e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit si dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese në Qark.

DREJTUESI I PROKURORISË
XHEVAHIR LITA



68

